

1 E hënë, 1 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 10.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
7 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
8 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
9 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që të  
11 të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallë e gjyqit.

12 Sot do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04752.  
13 Përpara se të filloj me dëshmitarin, kam disa aspekte që dua  
14 të trajtojë paraprakisht.

15 Së pari, vërej që Urdhri për Zhvillimin e Procesit  
16 Gjyqësor ka udhëzime të qarta sa i takon kundërshtimeve që do  
17 të bëni. Veçanërisht, paragrafi 115 dhe 116 kërkojnë  
18 qartësisht që të kundërshtimet të argumentohen qartë dhe nuk  
19 lejohen kundërshtimet sipërfaqësore. Kemi vënë re që nuk është  
20 respektuar gjithmonë kjo gjë.

21 Ju rikujtoj dhe një herë që nuk duhet të ketë  
22 kundërshtime sipërfaqësore për pyetjet që bën pala  
23 kundërshtare ose Gjykatësit. Kundërshtimet mirëpritën nga  
24 Trupi Gjyqësor kur kanë dhe argumentet përkatëse por nuk kanë  
25 nevojë dhe për shtjellimi të gjera. Nëse nuk e kuptojmë një

1 kundërshtim ne bëjmë vetë pyetje sqaruese.

2 Nëse pala ka nevojë të japë parashtrimet sa i takon  
3 kundërshtimit, ku parashtrim duhet bërë pa praninë e  
4 dëshmitarit. Veçanërisht, mos flisni dhe mos komentoni në  
5 praninë e dëshmitarit që mund të ndikojnë në dëshminë e tij  
6 ose të saj.

7 Nëse një kundërshtim sipërfaqësor bëhet në praninë e  
8 dëshmitarit, Gjykatësi mund ta rrëzojë menjëherë kundërshtimin  
9 dhe do të thotë që kjo është në kundërshtim me Urdhrin për  
10 Zhvillimin e Procesit Gjyqësor.

11 Gjithashtu, rikujtoj edhe një herë, siç e thamë të  
12 premtën e javës së kaluar, që këtë javë do të kemi orarin pak  
13 të ndryshuar. Dëshmitari 04752 nuk do të japë dëshmi të martën  
14 pasdite, por ama do të jetë i gatshëm të japë dëshmi seancën e  
15 parë ditën e enjte. E rrjedhimisht, Dëshmitari me numër 04752  
16 do të japë dëshmi gjithë ditën të hënën, të martën deri në  
17 pushimin e drekës, gjithë ditën të mërkurën dhe vetëm seancën  
18 e parë ditën e enjte. Kemi Dëshmitarin 04051 dhe 04445 që do  
19 të dëshmojnë këto seanca që nuk do të mbulohen nga dëshmitari  
20 i ditës së sotme.

21 Së treti sa i takon kërkesës që ka bërë Mbrojtja e  
22 Selimit në parashtrimin e protokolluar 2414, kjo është një  
23 kërkesë sipas tyre që duhet përjashtuar dëshmia e Dëshmitarit  
24 04445, sepse, më 4 korrik, Mbrojtja duhet të përgatisë diçka.  
25 Dhe kjo -- për këtë Trupi Gjyqësor do të japë urdhër ZPS-së që

1 të kundërpërgjigjet deri nesër në orën 9.00, pra, sa i takon  
2 kundërshtimit që ka paraqitur Mbrojtja e Selimit.

3 Z. Misetiç, ju kishit një aspekt gjithashtu që deshët të  
4 trajtonit për dëshmitarin e radhën. Ju lutem vijoni.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mesa kuptojmë, është dorëzuar një  
6 organigramë që pretendohet se është mbështetur në dëshminë e  
7 dëshmitarit. Dhe sot na thanë që nuk do t'i tregohet  
8 dëshmitarit kjo organigramë. Por ne, mesa kishim kuptuar,  
9 Trupi Gjykses kishte komentuar që këto organigrama i duhen  
10 treguar dëshmitarit. E nëse nuk i tregohen dëshmitarit,  
11 atëherë për ne kjo nuk ka asnjë vlerë për këtë pjesë të  
12 dëshmisë së dëshmitarit, prandaj ne kundërshtojmë që të bëhen  
13 pyetje lidhur me organigramën në këtë rast.

14 Sa i takon organigramës konkrete. Pikë së pari, ne nuk  
15 besojmë që dëshmitari ka thënë që z. Thaçi i raportonte  
16 komandantit të përgjithshëm të UÇK-së përmes Sokol Bashotës  
17 siç tregohet në organigramë, por ka thënë që z. Thaçi i ka  
18 raportuar drejtpërdrejt komandantit të përgjithshëm të UÇK-së.

19 Gjithashtu, kjo organigramë tregon sikur  
20 zëvendëskomandantët janë në të njëjtin nivel hierarkik si  
21 komandanti i përgjithshëm, nuk e kemi të qartë kur paska thënë  
22 dëshmitari që zëvendëskomandantët qenkan në të njëjtin nivel  
23 si komandanti i përgjithshëm i UÇK-së. Këto janë kundërshtimet  
24 tona.

25 Gjithashtu dua të shtoj këtu nëse doni që ta shfrytëzoni

1 ju këtu organigramën për t'u orientuar vetë për dëshminë e  
2 dëshmitarit dhe nuk do t'i tregohet kjo dëshmitarit a pajtohet  
3 a s'pajtohet dëshmitari në mënyrën sesi është përgatitur kjo  
4 organigramë, atëherë mbase është nevoja që të bëjmë një  
5 diskutim *inter partes*, sepse ne duam të bëjmë komentet tona  
6 për këtë organigramë dhe mbase të gjitha Ekipet e Mbrojtjes  
7 mund t'i bëjnë me shkrim komentet që kemi lidhur me këtë  
8 organigramë.

9 Paraprakisht, këto ishin kundërshtimet tona, të  
10 përgatisim dhe ne një organigramë dhe do t'ia paraqesim  
11 dëshmitarit sa i takon organizimit të UÇK-së. Faleminderit.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në fakt organigrama është  
13 pikërisht ajo që ka thënë dëshmitari. Nëse Avokati ka  
14 konstatuar ndonjë gabim, atëherë le të na e thotë e le ta  
15 trajtojmë së bashku. Po sikurse ju thamë edhe një herë *inter*  
16 *partes*, nuk do ia tregojmë dëshmitarit organigramën. Thjesht e  
17 kemi ne atë si një material mbështetës.

18 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
20 Do të marrim vendim më vonë lidhur me organigramën. Në fakt  
21 organigrama nuk është pranuar të paraqitet si provë gjyqësore,  
22 kështu që duhet të vendosim më vonë në lidhje me të. Në  
23 rregull.

24 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin, a

1 mund t'ju pyes si e kemi orarin për sot?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
3 që ma the në fakt. Do kemi pushimin 11.00.

4 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] do kemi bëjmë  
6 gjysmë ore pushim në orën 11.00 dhe do të vazhdojmë sipas  
7 orarit që kemi zakonisht për seancat tona.

8 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Po  
9 përpara se të fillojmë me dëshminë, ju duhet të bëni betimin  
10 solemn. Është ai teksti që po jep Asistentja e Sallës. Ju  
11 lutem lexojeni me zë të lart.

12 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime  
13 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të  
14 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
15 nuk do të mbaj të fshehur asgjë për të cilën kam dijeni.

16 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
18 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

19 Z. Avokat, ju lutem mund të prezantoheni.

20 Z. VANREUSEL: [Përkthim] Unë jam avokati i caktuar nga  
21 Gjykata për z. Zyrapi. Quhem Rik Vanreusel.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
23 sot do të fillojmë me dëshminë tuaj sikurse e ceka pak më  
24 herët. Dëshmia juaj mendohet se sot ë zgjasë rreth shtatë  
25 ditë. Sikurse e dini, në fillim ua bën pyetjet Prokuroria e më

1 pas Ekipet e Mbrojtjes kanë pyetje për ju, por edhe Gjykatësit  
2 e Panelit mund të kenë pyetje për ju.

3 Prokuroria ka kërkuar tetë orë për t'ju marrë në pyetje.  
4 Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar rreth 25 orë. Inkurajoj të  
5 gjitha palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e  
6 kohës kur të bëjnë pyetjet. Trupi Gjykues mund të lejojë  
7 pyetje shtesë nëse përmbushen pyetjet përkatëse.

8 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni qartë me fjali të  
9 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkonit që  
10 pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni dhe do  
11 ta sqarojmë pyetjen për ju.

12 Gjithashtu na thoni ku i bazoni ju faktet, rrethanat dhe  
13 njohurinë për të cilat do t'ju bëjnë pyetje. Në qoftë se ZPS-  
14 ja ju kërkon të flisni për korrigjimet që i keni bërë  
15 deklaratave tuaja ju lutem thoni me zë për procesverbal që  
16 deklarata juaj, bashkë me korrigjimet përkatëse pasqyron  
17 saktësisht dëshminë tuaj.

18 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara  
19 se të përgjigjeni dhe ju lutem flisni ngadalë për hir të  
20 përkthyesve.

21 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit,  
22 nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj  
23 jashtë sallës së gjyqit. Nëse ndokush jashtë sallës së gjyqit  
24 ju bën pyetje për dëshminë tuaj, ju lutem na informoni.

25 Gjithashtu, nëse unë ju kërkoj të mos flisni më, pushoni.

1 Dhe gjithashtu pushoni nëse unë ngre dorën. Se kjo do të thotë  
2 që unë duhet t'ju japë një udhëzim. Nëse keni nevojë për  
3 pushim, në çdo moment na thoni që të bëjmë organizimin  
4 përkatës.

5 Ka dhe një aspekt tjetër që duhet të trajtojmë para se të  
6 fillojmë me pyetjet e ZPS-së. Ne jemi në dijeni që ju është  
7 caktuar një avokat pasi ekziston rreziku i vetinkriminimit  
8 gjatë dëshmisë suaj.

9 Dëshmitar, ju rikujtoj që sipas betimit solemn që sapo  
10 lexuat, jeni i detyruar të thoni të vërtetën. Ju nuk duhet t'u  
11 përgjigjeni pyetjeve sidoqoftë që janë inkriminuese për ju, me  
12 përjashtim të rasteve kur ju detyron Paneli i Gjykatësve në  
13 bazë të rregullës 151(2) dhe kur vendosë se ju është dhënë  
14 garancia sipas rregullës 151(3).

15 Nëse ju bëhet një pyetje që është vetinkriminuese, ju  
16 përmes Avokatit, mund ta ngrini këtë çështje me Trupin Gjykses  
17 dhe do vendosim ne pastaj a do ta lejojmë këtë pyetje dhe nëse  
18 do të përgjigjeni ju apo jo.

19 Po përpiqem t'ua bëj të qartë këtë sepse ju keni të  
20 drejtën tuaj të mos përgjigjeni dhe këtë mund ta bëni përmes  
21 Avokatit tuaj.

22 Dëshmitar, tani do të fillojmë me pyetjet. Do të fillojmë  
23 me pyetjet nga Prokuroria që është në të majtën tuaj. Ju lutem  
24 dëgjojini me vëmendje.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

1 Pyetje nga znj. Lawson:

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjes, z. Zyrapi.

4 PË. Mirëmëngjesi.

5 PY. Jemi takuar bashkë më përpara. Unë jam Prokurorja që do  
6 t'ju bëj pyetjet sot në emër të Prokurorisë edhe nesër.

7 Sikurse ju tha Gjykatësi, nëse nuk e kam pyetjen të qartë, më  
8 thoni ju lutem dhe unë me kënaqësi do ta përsëris ose do ta  
9 riformuloj.

10 Sikurse ta shpjegova javën e kaluar, nuk do t'ju bëj  
11 pyetje për çdo temë të mundshme, ekziston dhe mundësia që disa  
12 nga deklaratat e mëparshme t'i pranojmë si provë gjyqësore. Në  
13 mënyrë që ta bëjmë këtë, ka disa hapa që duhet të ndjekim.

14 Ju lutem për procesverbal na thoni ermin dhe mbiemrin?

15 PË. Unë quhem Bislum Zyrapi.

16 PY. Cila është datëlindja juaj?

17 PË. Datëlindja është 9 korrik 1962.

18 PY. A ju kujtohet që ju dhamë mundësinë që të rilexonit edhe  
19 një herë deklaratat e mëparshme dhe dëshmitë javën e kaluar?

20 PË. Po.

21 PY. Kur dhatë këto deklarata dhe dëshmi, me aq sa keni ju  
22 dijeni, ishit i vërtetë, thatë të vërtetën?

23 PË. Po, plotësisht.

24 PY. A ju kujtohet që ju dhamë mundësinë të bënit disa  
25 korigjime dhe disa sqarime në ato deklarata javën e kaluar



1 konkretisht?

2 PË. Po.

3 PY. A ju kujtohet që këto sqarime dhe korrigjimet i hodhëm në  
4 një shënim dhe këtë shënimin ta lexuam sërish?

5 PË. Po.

6 PY. Faleminderit. Gjatë dëshmisë tuaj do t'ju referohemi disa  
7 deklaratave, megjithatë për momentin do të fokusohem vetëm në  
8 dy syresh.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Fillimisht do kërkoja të shfaqej  
10 në ekran materiali me numër IT-05-87.1 P00428-80.

11 PY. Z. Zyrapi, a ju kujtohet që e keni dhënë këtë dëshmi për  
12 TPNJ-në, ish-Tribunalin e Hagës në nëntor të 2006?

13 PË. Po.

14 PY. A ka qenë kjo pjesë e materialeve që keni lexuar javët e  
15 fundit?

16 PË. Po.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do lutesha Sekretares të  
18 vendos në ekran materialin me numër 083280-TR-AT Pjesa 1.

19 PY. A ju kujtohet që keni dhënë këtë intervistë për ZPS-në në  
20 vitin 2019?

21 PË. Po.

22 PY. A ka qenë edhe kjo intervistë pjesë e materialeve që keni  
23 lexuar javët e fundit?

24 PË. Po.

25 PY. Duke marrë parasysh korrigjimet dhe sqarimet që bëtë

1 javën e kaluar dhe që ne ua lexuam ju sërish, informacioni që  
2 është në këto deklaratat që sapo pamë, është i saktë dhe i  
3 vërtetë me aq sa keni ju dijeni dhe me aq sa besoni ju?

4 PË. Po.

5 PY. Edhe një herë, duke marrë parasysh edhe korrigjimet që  
6 hodhët tek ai shënim, deklaratat e mëparshme a pasqyrojnë  
7 saktësisht dëshminë tuaj dhe përgjigjet që do të jepnit sërish  
8 nëse do t'ju pyesin për të njëjtat tema?

9 PË. Po.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj të  
11 pranohen deklaratat e mëparshme dhe provat materiale  
12 shoqëruese. Numrat përkatës ua kemi dërguar me postë  
13 elektronike javën e kaluar. Gjithashtu kërkojmë që të pranohet  
14 Shënimi Përgatitor 1, versioni i korrigjuar, që ka numër  
15 121756 RED.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
17 kundërshtime?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Përveç kundërshtimeve që kemi  
19 ngritur më përpara, nuk kemi kundërshtime shtesë.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] E njëjta gjë vlen dhe për ne.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] E njëjta gjë për ne.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Materiali me numër IT-05-87.1 P00428-80 pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Propozoj që të  
25 qarkulloj fillimisht listën me të gjitha deklaratat përkatëse

1 edhe numrin e provave materiale shoqëruese për të gjithë  
2 pjesëmarrësit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt është  
4 zgjidhje mirë kjo, sepse ka shumë numra.

5 Në rregull. Fillimisht pranojmë 083280-TR-AT Pjesa 1.  
6 Shënimin Përgatitor numër 1 dhe provat materiale shoqëruese.  
7 Shënimi Përgatitor numër 1 ka numrin 121756 RED edhe provat  
8 materiale shoqëruese. Dhe sikurse u propozua, në email do t'ju  
9 jepet shënimi më vonë palëve nga Njësia e Administrimit të  
10 Gjykatës ku të kenë mundësi të shohin të gjithë numrat  
11 përkatës.

12 Znj. Lawson, vazhdoni.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

14 PY. Dëshmitar, meqë tashmë janë pranuar deklaratat, unë nuk  
15 do t'ju bëj më pyetje për të gjitha ngjarjet që përshkruhen në  
16 to, po do të fokusohem tek informacionet shtesë që na  
17 nevojiten. Me aq sa mundem do të vazhdoj në rend kronologjik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
19 përpara se të vijoni, deklarata ka Pjesën 1 apo po kërkonit që  
20 të pranohen të gjitha pjesët?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, kërkojmë që të pranohen të  
22 gjitha pjesët nga 1 deri në 14, pra, deklarata është me 14  
23 pjesë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
25 [Përkthim] Në rregull. Meqë kjo nuk u zbardhë për

1 procesverbal, po e them edhe një herë që pranohen të 14 pjesët  
2 e deklaratës të intervistës së ZPS-së.

3 Emmerson, më falni që ju ndërpreva.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Kam nevojë për  
5 një sqarim për urdhrin që sapo dhatë sa i takon pranimin të  
6 provave materiale, thatë ju, të Shënimit Përgatitor 1, nuk e  
7 kam të qartë për çfarë e kishit fjalën.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
9 [Përkthim] Provat materiale shoqëruese që janë pjesë e  
10 intervistës.

11 Kështu, znj. Lawson?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, për këtë bëhet fjalë.

13 PY. Në rregull, Dëshmitar, siç ju thashë pak më herët, do  
14 përpiqem të ndjek rend kronologjik dhe do të fillojmë në mars,  
15 prill dhe maj të 1998. A ka pasur luftime në Kosovë në këtë  
16 periudhë kohore, pra, mars, prill, maj 1998?

17 PË. Në atë periudhë unë nuk kam qenë brenda. Po si mbas  
18 informacioneve atëherë që dihet që në mars ka pasun luftime  
19 edhe në Drenicë, ku dihet dhe në atë kohë dhe masakra e  
20 familjes Jasharaj. Dhe pastaj ka pasur edhe në disa vende të  
21 tjera të cilat kanë qenë dhe në prill dhe në maj gjatë kësaj  
22 kohe.

23 PY. Si i mësuat, si mësuat ju për këto luftime, nga i  
24 dëgjuat?

25 PË. Kam ndëgjuar nga kolegët sa isha në Tiranë. Nga anëtarët,

1 të cilët ishin anëtarët e logjistikës në asaj kohe se si dhe  
2 çka po ndodhë në Kosovë. Dhe që atëherë kam mësuar nga ta.  
3 PY. Gjatë kohës që ishit në Shqipëri dhe prisnit miratimin  
4 për t'u kyçur në UÇK, ju thatë që një nga detyrat tuaja ishte  
5 të bënit një kontroll teknik të armëve.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për hir të palëve, i referohem,  
7 faqes 18, të Pjesës 1.

8 PY. Kush ua dha ju këtë detyrë?

9 PË. Në atë kohë kam punuar së bashku me anëtarët e  
10 logjistikës, të cilët kanë qenë ilir Konushevci, Raif Gashi,  
11 Naimi, ndryshe Dilaveri me pseudonim. Me ta zakonisht kam  
12 shkue, të cilët kanë kërkue për t'u inspektuar armët ose për  
13 t'i shikuar armët në teknikë a janë në rregull për të blerë  
14 dhe për të mujt për të dërguar për përdorim në Kosovë.

15 PY. Kush ka qenë përgjegjës për blerjen e armëve?

16 PË. Në atë kohë, folim për marsin edhe prillin, unë e kam  
17 ditur për këta persona të cilën kanë pas mundësinë dhe kanë  
18 blerë armë. Kush ka qenë tjetër nuk e di.

19 PY. E keni fjalën për drejtorinë e logjistikës së UÇK-së,  
20 pra, anëtarë të logjistikës së UÇK-së me të cilët punonin në  
21 Shqipëri kur thatë "këta"?

22 PË. E kam fjalën po për këta personat që kanë punu në  
23 logjistikën e UÇK-së. Në atë kohë a quajt drejtori nuk e di,  
24 po ata kanë qenë përgjegjës për logjistikën në Shqipëri.

25 PY. Çfarë armësh, çfarë lloj armësh po merrnit?

1 PË. Zakonisht në atë kohë blejshim armët të cilat na  
2 nevojitshin për nevoja për luftë si të ishin armët e  
3 këmbësorisë. Zakonisht janë kanë armët Kallashnikov, AK-47,  
4 ose pushkë gjysëautomatike, kanë qenë armët antitank siç janë  
5 RPG-të 150, 500, armë mitrolozë të rëndë, 12.7. Atë çka kemi  
6 mujt ta gjejmë për t'i blerë gjatë asaj kohe.

7 PY. Flasim për pjesën kur shkuat në Drenoc me grupin tuaj në  
8 Kosovë, kur hytë në Kosovë. Kush ju priti atje?

9 PË. Po në maj të 1998 kur kemi hyrë në Kosovë, në fshatin, së  
10 pari jemi bazu në fshatin Drenoc. Në Drenoc atëherë na është  
11 pritur një pjesë të komandës të shtabit lokal të Drenocit të  
12 cilët kanë qenë, në atë kohë, ka qenë xhemë Gashi ose ndryshe  
13 Gjermani me pseudonim, Isuf gashi, ka qenë pjesë e asaj  
14 komandës, 500-shi ose Zyberi mbiemrin, Mensuri. Mensur Zyberi.  
15 Ishin ata që na pritën në këtë fshat.

16 PY. I njihnin ata anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm me të  
17 cilët po udhëtonit ju?

18 PË. Po.

19 PY. Nga e njihnin njëri-tjetrin?

20 PË. Na njifshin dhe më herët. Se anëtarët e shtabit, që ishin  
21 me mua bashkë, ata ishin takuar dhe më herët dhe kishin kalue  
22 se baza e Drenocit ka qenë si një ndër bazat të cilat janë  
23 lëvizur nga Shqipëria në Kosovë dhe nga Kosova anasjellës në  
24 Shqipëri përmes asaj baze.

25 PY. Dua t'ju tregoj një dokument.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ka numër P01269 MFI, pra i  
2 shënuar për identifikim. Anglishtja përfundon me -ET në fund.  
3 Edhe mund të përcillet edhe për publikun.

4 PY. Së pari, Dëshmitar, kush është Daja që duket në këtë  
5 tekst të cilit i drejtohet kjo?

6 PË. Nuk po e di saktë. Po "Daja" në atë kohë dhe ne i kemi  
7 thënë komandantit të përgjithshëm Azem Sylës.

8 PY. Dhe ju keni shpjeguar tashmë që Gjermani është Xhemë  
9 Gashi në shtabin e Drenovcit, është e saktë kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Informacioni në këtë dokument a është i saktë?

12 PË. Informacioni është i saktë për çka po flitet dhe çka  
13 është e shkruar.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar, dëshiroj që këtë  
15 dokument ta dorëzojmë si provë. Në fakt nuk ka pasur numër.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
17 kundërshtime?

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ky dëshmitar nuk është autori  
19 i këtij dokumenti dhe nuk ka prova se i kujt është shkrimi apo  
20 nëse kanë qenë disa persona të ndryshëm që e kanë shkruar atë.  
21 Nuk ka as prova se nga ka ardhur ky dokument.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndokush  
23 tjetër?

24 Atëherë ky dokument me numrin P01269 MFI-ET, pranohet dhe  
25 do t'i jepet një numër prove.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky  
2 dokument tashmë do të marrë numrin P01269. Dhe si klasifikim  
3 është konfidencial.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të klasifikohet publik.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të  
6 riklasifikohet si dokument publik, ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj t'ju tregoj edhe një  
9 dokument tjetër. I cili ka numrin P0063 MFI, pra, një numër  
10 provizor. Në versionin anglisht në fund të numrin mbas MFI  
11 kemi dhe shkronjat ET. Dhe mund të shfaqet në ekran.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E nderuar  
13 Prokurore, numrin e dhatë 0063 apo 00663?

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E dyta, 663.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë duhet  
16 të rregullojmë procesverbalin që të pasqyrojë shifrat 663.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, ky dokument i referohet Mahir Hasanit. A ka  
19 qenë ky një nga oficerët që ka hyrë në Kosovë me ju në atë  
20 kohë?

21 PË. Po.

22 PY. A është e saktë që ai kishte kryer akademinë ushtarake?

23 PË. Po. Ka kryer shkollën ushtarake në ish-Jugosllavinë.

24 PY. A është e saktë gjithashtu që atë e kanë caktuar që të  
25 qëndrojë në Drenoc me shtabin atje?



1 PË. Po.

2 PY. Këtu i referohet Bisit, që besoj që jeni ju dhe Magjupi,  
3 a e dini se në këtë kontekst kush është Magjupi?

4 PË. Nuk e di në këtë konteskt. E di që Magjupi i kanë thënë  
5 Lahi Brahimit, po aty në atë kohë s'ka qenë Lahi Brahimi. Bisi  
6 jam unë. Dhe normalisht që komanda lokale ka kërkuar që të  
7 ndalet Mahir Hasani aty dhe t'i ndihmon për organizimin e  
8 kësaj, këtij shtabit lokal dhe unë jam pajtuar me atë punë.

9 PY. Atëherë përveç referimit për Magjupin këtu, pjesa tjetër  
10 e dokumentit a është e saktë?

11 PË. Është e saktë se unë e kam aprovuar që të jetë Mahir  
12 Hasani aty dhe Gjermani si komandant i shtabit lokal që ka  
13 ekzistuar në atë kohë. Po, është e saktë.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar, sërish dëshiroj të  
15 kërkoj që të pranohet si provë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
17 kundërshtime?

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të njëjta kundërshtime  
19 përfshirë faktin që ky dokument nuk duket që të jetë dokument  
20 i plotë. Në pjesën e poshtme në të djathtë ka ende disa detaje  
21 që mungojnë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
23 Atëherë, dokumenti P00663 MFI-ET pranohet dhe do t'i caktohet  
24 një numër prove.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar, ky dokument

1 tashmë merr numrin P00663 dhe klasifikohet si publik.

2 Faleminderit.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

4 PY. Tani dëshiroj që të kalojmë tek momenti kur keni arritur  
5 në Likoc, Dëshmitar. Kë keni takuar në momentet e para, në  
6 ditët e para që keni arritur atje?

7 PË. Në ditën e parë që kemi arritur në Likoc së bashku me  
8 grupin që kemi qenë, përveç grupit të anëtarëve që kanë qenë  
9 të shtabit me mua së bashku, kam takuar dhe Sokol Bashotën -  
10 ne folim ditën e parë - dhe kanë qenë komandanti i zonës së  
11 Llapit, Rrustem Mustafa dhe i zonës së Shalës, Rrahman Rama.

12 PY. Dhe pak më pas u takuat me të tjerët, pra, ata që ishin  
13 në komandë?

14 PË. Me këta të cilët veç i ceka, me këta që isha bashkë si  
15 anëtarë të shtabit dhe pastaj kam taku Sokol Bashotën, pastaj  
16 kam taku Rexhep Selimin. Por do tjerë nuk kam takuar, folim  
17 për ditët e para. Mbasandej po.

18 PY. Atëherë kur u takuat për herë të parë me Sylejman  
19 Selimin?

20 PË. Mund të thuhet para disa ditëve. Pasi më është dhënë që  
21 të vizitoj zonën e Drenicës dhe t'i ndihmoj për ristrukturim.  
22 Dhe vizitën e kësaj zone dhe këtyre njësive atëherë e kam  
23 takue dhe jam njoftu me to për herë të parë si komandant i  
24 zonës dhe kam mujt të hyj dhe të vizitoj zonën dhe të punoj  
25 dhe t'i ndihmoj në riorganizimin e saj.

1 PY. A e mbani mend se ku e keni takuar atë?

2 PË. Për momentin, jo. Ka mund të jetë edhe në Likovc, ka mund  
3 të jetë edhe në ndonjë fshat tjetër të Drenicës.

4 PY. Dhe oficerët që hynë me ju, a u caktuan zona për ta? Në  
5 cilat zona u caktuan ata?

6 PË. Po, mbasi kemi hy na në ditën e parë, atëherë unë kur e  
7 ceka më herët, kur i kam taku në shtab. Komandanti i zonës së  
8 Llapit ka qenë aty, i zonës së Shalës ka qenë aty. Ata i kanë  
9 marrë një pjesë të eprorëve. Për Llap e ka marrë Rustem  
10 Mustafa e ka marrë Kadri Kastratin, kurse për zonën e Shalës  
11 Rrahman Rama e ka marrë Mensur Kasumin edhe Hysni Ahmetin. Dhe  
12 normalisht ata menjëherë i kanë marrë dhe kanë shku në zonat e  
13 tyre për shkak se janë të atyne zonave dhe të këtyre  
14 territoreve dhe ata janë njoft edhe ma herët.

15 PY. A mbani mend se kur e keni takuar për herë të parë Jakup  
16 Krasniqin?

17 PË. Në qershor të 1998 kur ka ardhë ka marrë detyrën e  
18 zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të shtabit.

19 PY. A e mbani mend se kush tjetër ka qenë i pranishëm atë  
20 ditë kur jeni takuar me të për herë të parë?

21 PË. Po për herë të parë me të jemi takuar jashtë në oborrin e  
22 një shtëpie private ku ishim, së bashku ka qenë me Sokol  
23 Bashotën.

24 PY. Ndokush tjetër?

25 PË. Jo, nuk kam qenë në takim mbrenda me pa me kën ka qenë.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që në ekran të shfaqet  
2 materiali P00606, versioni anglisht ka shkronjat ET në fund.  
3 PY. Dëshmitar, tani do të shfaqet në ekran një intervistë që  
4 ju i keni dhënë *Zërit* në vitin 1999. E mbani mend atë  
5 PË. Po.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë kalojmë në faqen 3 të  
7 versionit anglisht, ju lutem. Ndërkohë që në gjuhën shqipe  
8 është kolona e tretë poshtë kutisë me tekst. Faleminderit.  
9 PY. Do të lexoj një pjesë të saj.

10 "Pas këtij kontrolli u ktheva në bazë dhe Hashim Thaçit i  
11 raportova gjetjet e mia, Kadri Veselit dhe Sokol Bashotës. Atë  
12 datë unë pata një takim me dhe njoha Jakup Krasniqin, i cili  
13 pikërisht atëherë pranoi detyrën e zëdhënësit të UÇK-së. Në  
14 atë kohë ishte çështja e Kijevës e cila ishte rrethuar nga  
15 njësite të UÇK-së dhe ishte një çështje goxha problematike.  
16 Unë raportova për situatën në terren përpara anëtarëve të  
17 Shtabit të Përgjithshëm dhe u sugjerova se çfarë veprimesh të  
18 tjetër duheshin ndërmarrë".

19 Kjo gjë që sapo lexova, a është e saktë?  
20 PË. Po.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë mund ta heqim nga ekrani  
22 dokumentin.

23 PY. Ju keni shpjeguar se si në Likovc u caktua detyra për të  
24 vizituar njësite të ndryshme dhe që të jepnit propozime për  
25 riorganizimin dhe për trajnimet.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe kjo ka të bëjë, është thënë  
2 në Pjesën 2 të intervistës me ZPS-në në faqen 8.

3 PY. Ku ishte ky vend ku filloj kjo detyrë e riorganizimit?

4 PË. Riorganizimet kanë filluar qysh nga fillimi kur kam  
5 shkue. Se me përcaktimin tim si oficer për zhvillim  
6 profesionalizim në kuadër të drejtorisë operative e kam pas  
7 këtë detyrë që të punoj dhe të shikoj mirë sesi është gjendja  
8 në territor ose në terren dhe pastaj të jap propozimet se si  
9 të organizohet ose si të shkon zhvillimi i mëtutjeshëm i  
10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ka fillu njëheri me  
11 marrjen e kësaj detyre.

12 PY. Dhe në cilën zonë keni filluar punën së pari?

13 PË. Së pari kam fillu në Drenicë, pastaj në zona tjera.

14 PY. Kush jua ka caktuar këtë detyrë?

15 PË. Po për të shkuar me të punuar në këto drejtime dhe për të  
16 parë dhe të përcaktuara atë kohë Sokol Bashota, nga drejtoria  
17 operative.

18 PY. Kush ju ka kërkuar që të shkonit në Drenicë, pra, për të  
19 filluar me Drenicën?

20 PË. Sokol Bashota.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që me lejen e Gjykatësve  
22 të vendosim në ekran një deklaratë të mëparshme e cila ka  
23 numrin IT-04-84 T675 për versionin në anglisht dhe i njëjti  
24 numër edhe për gjuhën shqipe por me AT në fund.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të kemi një shpjegim se

1 përse do të vendoset kjo deklaratë e mëparshme? Nuk e kuptojmë  
2 se përse dëshiron Prokurorja që ta bëjë këtë në këtë moment.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në përgjigje të asaj që tha  
4 dëshmitari kur iu përgjigj kësaj pyetjeje për të parë nëse  
5 mund ta ndihmojmë me kujtesën.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po ai nuk tha që ka harruar ai  
7 ndonjë gjë. Thjesht që të jemi shumë të qartë që prej fillimit  
8 për çfarë arsye po e bëjmë këtë gjë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Që të korrigjohet dëshmia e tij?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atë që u tha.  
12 Le t'i japim Prokurores kohë që të bëjë punën e vet.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Por nuk ka nevojë për të  
14 rifreskuar kujtesën e dëshmitarit sepse nuk ka harruar ndonjë  
15 gjë, i nderuar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Megjithatë të  
17 shikojmë se çfarë do të thotë, pra, Prokurorja dhe nëse ka  
18 ndonjë gjë ndryshe nga ajo dhe të shikojmë, pastaj nëse do të  
19 ketë kundërshtim.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

21 Atëherë nëse mund të shkojmë në faqen 757 në të dyja  
22 gjuhët, ju lutem.

23 PY. Do të lexoj nga rreshti 2 deri në 7 në gjuhën shqipe. Ju  
24 thoni:

25 "Nuk e mbaj mend saktësisht sa kohë qëndrova, nëse ishte

1 dy apo tre ditë, nuk e di, por ishte një periudhë shumë e  
2 shkurtër kohore, pas së cilës, sipas urdhrave të lëshuara nga  
3 komandanti operacional i asaj kohe Rexhep Selimit, u ngarkova  
4 me detyrën për të shkuar në zonën operacionale të Drenicës për  
5 të dhënë këshillat e mia për zhvillimin e zonës operative të  
6 Drenicës".

7 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, të dyja, e saktë dhe Sokol Bashota dhe Rexhep Selimi  
9 të dytë kanë qenë në drejtorinë operative. Kështu që mu më  
10 kujtohet se dhe prej, bile në kohën e të parën kur kam dalë  
11 për të vizituar Drenicën ka qenë nga Sokol Bashota, pastaj nga  
12 Rexhep Selimi.

13 PY. Faleminderit. A keni shkuar në Llapushnik në qershor ose  
14 korrik të 1998?

15 PË. Po.

16 PY. A e mbani mend sesa herë keni shkuar atje?

17 PË. S'më kujtohet saktë, por më duket nja dy-tri herë, po.

18 PY. Atëherë të flasim pak për herën e parë. A e mbani mend me  
19 përafërsi se kur ka ndodhur kjo dhe pse keni vajtuar atje?

20 PË. Për herën e parë kemi shkuar për të vizituar ato  
21 pozicione dhe më duket atëherë herën e parë ka qenë kur kemi  
22 vendosur mitralozin 12.7, a është vendosur në pozicion të mirë  
23 apo jo. Më duket, sa më kujtohet.

24 PY. Atëherë me kë keni vajtur atje?

25 PË. Në atë kohë një herë që më kujtohet kam vajt bashkë me

1 Rexhep Selimin.

2 PY. Ndokënd tjetër?

3 PË. Ka qenë edhe komandanti i njësisë lokale të Llapushnikut,  
4 folëm për herën e parë. Pastaj dhe një herë ka qenë edhe  
5 Fatmir Limaj.

6 PY. A besoni që Fatmir Limaj ka qenë aty në një moment tjetër  
7 ose herë tjetër sesa kjo për këshilla për vendosjen e armës?

8 PË. Ju ma bë të këtë pyetje sa herë. Unë thashë që dy-tri herë  
9 kam qenë. Domethënë, hera a ka qenë herën e dytë a tretën a  
10 kur kemi kalu aty po. Po s' do të thotë që bash ka qenë për  
11 armën apo për çka ka qenë. Tash s' më kujtohen ato detajet.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar, do t' i referohem një  
13 deklaratë të mëparshme të dëshmitarit për ta ndihmuar me  
14 kujtesën në këtë moment.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni  
16 këtë gjë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dokumenti ka emërtimin IT-03-66  
18 T6837. Është faqja 6857 në gjuhën angleze dhe faqja 23 deri në  
19 faqen 24 në gjuhën shqipe. Faleminderit.

20 PY. Atëherë nga rreshti 9, kur juve ju bëhet kjo pyetje:

21 "Në këtë rast ishit ju, Fatmir Limaj dhe kush tjetër  
22 shkoi, nëse ju kujtohet?"

23 Dhe përgjigja juaj është:

24 "Agimi, Agim Qelaj dhe Hansi. Hansi është pseudonimi i  
25 personit të quajtur Nusret Krasniqi. Ai ishte oficer ushtrie



1 me përvojë sepse kishte shërbyer në ushtrinë e ish-  
2 Jugosllavisë dhe shërbente si shoqëruesi ynë gjatë vizitave  
3 tona në shumë vende.”

4 Dhe tani dua të vijojmë në pjesën e poshtme të faqes dhe  
5 pyetja është:

6 “Në Llapushnik keni shkuar me Fatmir Limajn apo ai ishte  
7 atje kur ju mbërritët?”

8 Dhe përgjigja juaj ka qenë:

9 “Më kujtohet që u takuam rrugës midis fshatrave Arllat  
10 dhe Llapushnik. Mendoj se kur u takuam ai ishte me Rexhep  
11 Selimi, mendoj. Dhe na porositi që të shkonim ta shihnim këtë  
12 armë dhe t’i ndihmonim ushtarët që ta vendosnin atë në  
13 pozicionin më të mirë të mundshëm në Grykën e Llapushnikut.

14 “PY. Kush ju udhëzoi? Fatmir Limaj?

15 “Jo. Kur u takuam me të ishte Rexhepi dhe ai tha që të  
16 shkojmë së bashku me Fatmirin për të parë se ku ishte vendosur  
17 mortaja 12.7 që të sugjeronim vendndodhjen më të mirë të saj”.

18 Po e lë me kaq leximin. A ju ndihmon kjo pjesë që Fatmir  
19 Limaj ka qenë aty në rastin kur është vendosur arma së bashku  
20 me Rexhep Selimin?

21 PË. Po. Unë që e thashë që dikur ka qenë. Po nuk mu kujtoke  
22 saktë cilën kohë ka qenë, po qashtu ka qenë njëjtë sikur që  
23 kam dhënë deklaratën e mëhershme. Pikërisht qashtu ka ndodhë.

24 PY. Faleminderit. Kush ishin komandantët lokal me të cilët  
25 jeni taku atje?

1 PË. Aty jam takuar me komandantin lokal, domethënë, që ka  
2 qenë njësisë aty dhe është quajtur me pseudonimin Vogëlushi.  
3 Ndryshe Imer Alushani me emër dhe mbiemër. Ai ka qenë  
4 komandant në Llapushnik. Folim për pjesën anën e djathtë të  
5 rrugës të grykës së Llapushnikut.

6 PY. A kishte zëvendës?

7 PË. Më duket që po ka pas edhe zëvendës. Po tash s'më -- më  
8 duket që ka qenë me pseudonim Mësuesi, po nuk më kujtohet  
9 tash. Se kohë e gjatë është.

10 PY. Dhe ju thatë që kjo ka qenë në anën e djathtë të grykës.  
11 Po në anën tjetër kush ka qenë? Cili komandant ose cili  
12 njësit?

13 PË. Në anën e majtë të rrugës të grykës së Llapushnikut,  
14 domethënë, po folim rrugës anën e majtë në drejtim kur shkohet  
15 në drejtim të Prishtinës nga Malisheva, në anën e majtë ka  
16 qenë njësitë Pëllumbi që edhe ka udhëhequr në atë kohë Ferat  
17 Shala.

18 PY. Kur keni vajtur në Kleçkë për herë të parë?

19 PË. Data s'më kujtohet saktë, diku më kujtohet qershorit i  
20 1998 kur kam shku në drejtim të vijës së frontit. Më duket  
21 qershorit ka qenë.

22 PY. Dhe ju thatë që keni qenë pranë në vijën e frontit. Aty a  
23 kishit dhe ndonjë detyrë tjetër shtesë?

24 PË. Po atë ditë kur kam shkuar, domethënë, të vizitoja vijën  
25 e frontit të cili ishte në drejtim të Qafës së Duhlës, aty kam

1 pas detyrë që t'i ndihmoj njërive se si të rreshtohen, si të  
2 raportojnë, si të përshëndesin. Është edhe incizimi në të  
3 cilën duhet dhe tregohet si shembull sesi duhet të rreshtohen  
4 njësitë. Kjo ishte dita edhe kur kam kalu në Kleçkë për herë  
5 të parë dhe kur kam shkuar në vijën e frontit.

6 PY. A u takuat me komandantin atje në Kleçkë?

7 PË. Po. Unë aty jam takuar me Fatmir Limën dhe to së bashku  
8 kemi shkuar në vijën e frontit në drejtim në Qafës së Duhles.

9 PY. Shtabi i Përgjithshëm a ka patur ndonjë shtëpi ose një  
10 bazë në atë zonë në atë kohë?

11 PË. Sa më kujtohet, në atë kohë jo.

12 PY. A ju është dhënë ndonjëherë detyrë, për shembull, për të  
13 gjetur hapësira të tilla për Shtabin e Përgjithshëm?

14 PË. Po, më vonë. Ajo veç u kanë në kohën e nëntorit,  
15 dhjetorit kur kemi fillu ti gjejmë vendet dhe shtëpitë për  
16 vendosjen e Shtabit të Përgjithshëm në territorin e bjeshkës  
17 së Berishës, faktikisht në fshatin Divjakë.

18 PY. Okej. Po i referohem sërish periudhës së qershorit të  
19 1998.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kështu që me lejen e Gjykatësve,  
21 do të shfaqim në ekran deklaratën tuaj të mëparshme.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
23 vijoni.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca është IT-03-66 T6837.

25 Faqja 6854 deri në 6855 në anglisht dhe është faqja 19 në

1 gjuhën shqipe.

2 PY. Do të lexoj nga fillimi i faqes. Pyetja është:

3 "Ju dëshmuat se e patë Fatmir Limajn - më falni - se  
4 shkuat atje për ta ndihmuar dhe për të përgatitur një shtëpi  
5 për Shtabin Qendror. E saktë?"

6 Në rreshtin 9 përgjigja juaj:

7 "Po, e saktë".

8 Pyetja pastaj ishte sa kohë qëndruat ë Kleçkë në atë  
9 rast.

10 E mbani mend këtë, Dëshmitar?

11 PË. Po. Po, po.

12 PY. A e mbani mend se kush ju kishte kërkuar që të shkonit  
13 dhe të ndihmonit për përgatitjen e kësaj shtëpie ose çfarë  
14 detyre kishit?

15 PË. Në atë kohë më kujtohet mirë, më ka thënë Sokol Bashota  
16 nga drejtoria operative që gjejmë një shtëpi për drejtorinë  
17 operative të cilët do të ishte një dhomë operative, aty do të  
18 ishin hartat të gjitha që ne si oficerë do të punojshim në atë  
19 drejtim. Mirëpo nuk patëm sukses në atë drejtim të gjejmë në  
20 atë kohë, për arsye të veprimeve dhe punëve që ishin në atë  
21 kohë.

22 PY. Faleminderit. Tani dëshiroj t'ju tregoj një dokument  
23 tjetër.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a do të bëjmë  
25 pushimin në orën 11.00?

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë po e lë me kaq për tani.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
3 tani do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore, që është pak e  
4 pazakontë sepse sapo filluat, megjithatë do të rikthehemi në  
5 sallë në orën 11.30 dhe do të vijojmë.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në  
8 orën 11.30.

9 --- Seanca ndërpritet në orën 11.03

10 --- Seanca rifillon në orën 11.37

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.  
12 Mistic.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Lidhur me udhëzimin që bëtë më  
14 herët për këto kundërshtimet sipërfaqësore, tani dua të them  
15 diçka pa qenë nevoja ta nxjerrim dhe njëherë dëshmitarin nga  
16 salla.

17 Kjo që dua të them unë ka të bëjë me librat, veçanërisht  
18 librin e z. Krasniqi që do të përdoret, si dhe materialet që  
19 janë marrë ose nga z. Krasniqi ose nga z. Selimi. Tani  
20 kundërshtimi im është ky, që t'ia paraqesësh dëshmitarit dhe  
21 të thuash që ky është libri i z. Krasniqi është sugjestionues,  
22 sepse mund të ketë një lloj baze anshmërie. Kështu që për  
23 mendimin tim të pyetet një herë dëshmitari çfarë di për temën,  
24 dhe pastaj nëse lind nevoja për t'i treguar librin, ta bëjmë,  
25 por nuk është nevoja t'i thuash që ky libri i z. Krasniqi

1 sepse ju thashë dhe një herë ne mendojmë që kjo është  
2 sugjestionuese dhe tregon anshmëri.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë po  
4 kërkoni?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po them ta pyesim një herë çfarë  
6 di për një takim të caktuar apo çfarë di për çështjen në  
7 fjalë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju po i  
9 tregoni Prokurores si të bëjë punën? Ju s'keni asnjë bazë  
10 ligjore për këtë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Është sugjestionuese, po them.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E thoni që  
13 është sugjestionuese t'i thuash që është libri i filanit e  
14 fistekut?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mund të  
17 thuash, nuk mund të thuash që, thjesht, ja ku është një  
18 dokument, çfarë mendimi ke për të. I duhet thënë dëshmitarit  
19 diçka më shumë. Po t'i thuash dëshmitarit ja ku është një  
20 dokument, a është sugjestionues në vetvete? Po sugjestionuese  
21 është, por lejohet.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, unë po them këtë. Po t'i thoni  
23 atij që filani e fisteku ka thënë kështu e kështu, a pajtoheni  
24 ju me këtë përshkrim, unë mendoj që është sugjestionues.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej. Është

1 një kundërshtim që e rrëzoj.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë i pajtohem kundërshtimit  
3 të kolegut tim të nderuar.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
5 [Përkthim] Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin,  
7 kam një çështje që dua ta trajtoj. Faleminderit Sekretares që  
8 qarkulloi listën me numrat e paketës 154. Të gjitha materialet  
9 mund të riklasifikohen si publikë, me përjashtim të  
10 intervistave të ZPS-së, edhe Shënimi Përgatitor 1.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj dhe klasifikimin  
12 njësoj si me rastin e dëshmitarit të mëhershëm.

13 Intervista e ZPS-së është dëshmia e drejtpërdrejtë e  
14 dëshmitarit. Kështu që unë propozoj të bëjmë të njëjtën gjë që  
15 bëmë për dëshmitarin e mëparshëm. Nëse në intervistë ka  
16 materiale që duhen redaktuar, atëherë le të redaktohen. Edhe  
17 të jetë publike dëshmia e dëshmitarit, por nuk mund të thoni  
18 që e gjithë dëshmia të jetë konfidenciale e të jetë private.  
19 Ndërkohë që ne këtë dëshmitar e kemi në seancë publike.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] S'kemi kundërshtim, megjithatë  
21 dua t'ju them që nuk mund ta riklasifikojmë për momentin  
22 derisa të bëjmë redaktimet përkatëse.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur mendoni  
24 se do t'i bëni redaktimet?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po duhet të mbaroj të paktën

1 pyetjet dhe pastaj ta riklasifikojmë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
3 Ka kuptim.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Për mua të përdorim të njëjtën  
5 procedurë si me dëshmitarin e mëparshëm. Të bëhen redaktimet  
6 paralelisht me transkriptin, në mënyrë që të redaktojmë në të  
7 njëjtën kohë dhe t'i dorëzojmë në atë moment.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto gjëra  
9 është mirë që t'i diskutoni paraprakisht, të mos çojmë kohën  
10 dëm me këto aspekte.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
13 mirë se erdhët. Do të vazhdojmë. Prokuroria ka ende pyetje për  
14 ju, ju lutem dëgjojeni me vëmendje. Znj. Lawson, vazhdoni.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

16 Pyetje nga z. Lawson:

17 PY. Përpara pushimit, Dëshmitar, unë isha duke treguar një  
18 dokument tjetër.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Që është SPOE00232474. Anglishtja  
20 ka të njëjtin numër, por mbaron me ET në fund dhe është  
21 versioni i rishikuar.

22 PY. Së pari, Dëshmitar, në këtë dokument përmendet shtabi  
23 operativ lokal. Çfarë termi përdorej saktësisht në atë kohë?

24 PË. Po shtabet lokale operative në atë kohë përmendet ose  
25 kanë qenë njësi të shumta lokale, të cilat kanë qenë me emra



1 të ndryshme njësitë, grupi, jo njësi të organizuara në formën  
2 e plotë ushtarake. Për ato janë qujt si shtabet lokale  
3 operative. Se ne shtabet lokale operative i kemi qujt edhe ato  
4 të fshatrave, i kemi qujt edhe ato të komunave, edhe zonave,  
5 se, faktikisht, zona s'ka pas në atë kohë, janë kanë nënzonë,  
6 që kanë ekzistuar, dhe ma së shumti janë quajtur në atë  
7 terminologjinë shtabi lokal operativ.

8 PY. I njihni emrat që përmenden këtu, të njësiteve Çeliku dhe  
9 Lumi, ju thonë gjë?

10 PË. Po, i njof.

11 PY. A keni ndihmuar ju për unifikimin e këtyre komandave?

12 PË. Po, kam ndihmuar në qershor të vitit 1998.

13 PY. Dokumenti a përshkruan saktësisht strukturën e këtyre  
14 njësiteve të paktën siç e keni kuptuar dhe ju, që këto njësite  
15 të kenë qenë nën komandën e Musë Jasharit që ka qenë komandant  
16 i shtabit operativ lokal asokohe?

17 PË. Si dokument nuk e di, për herë të parë po e shof. Mirëpo  
18 është e vërtetë që njësitet Çeliku, Lumi, kanë qenë në zonën  
19 operative të Pashtrikut dhe Musë Jasharin në atë kohë është  
20 vendos si komandant i kësaj nënzona.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj të  
22 pranohet ky dokument.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. Nuk mund ta bëj  
24 kundërshtimin pa shpjeguar edhe qëndrimin tim. Por, nëse më  
25 lejoni nuk është treguar thelbi, çfarë thelbi ka ky dokument.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
2 [Përkthim] Atëherë, dëshmitari do të duhet të dalë pak  
3 nga salla.

4 Dëshmitar, do të duhet të dilni pak nga salla sepse duhen  
5 bërë disa parashtime pa praninë tuaj.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Dokumenti nuk  
8 ka as datë, as nënshkrim, as vulë. Prokurorja po pretendon se  
9 është lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm, dëshmitari ka qenë  
10 oficer në Shtabin e Përgjithshëm, dhe Prokurorja nuk i thotë  
11 çfarë di ti për këtë dokument, dhe a është lëshuar nga Shtabi  
12 i Përgjithshëm ky dokument. Ai ka qenë pjesë e Shtabit në atë  
13 kohë.

14 Pra, qëndrimi ynë është që ky është një dokument, është  
15 që ky dokument nuk ka ekzistuar asokohe. Dëshmitari sapo tha  
16 që për herë të parë e sheh tani. Ne kundërshtojmë që të  
17 pranohet ky dokument. Le t'i paraqitet ky dokument një  
18 dëshmitari që është kompetent dhe të flasë për autenticitetin  
19 dhe për autorësinë, dhe mendojmë që është e papërshtatshme  
20 mënyra që po zgjedh Prokuroria për të pranuar këtë dokument si  
21 provë gjyqësore.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Ka datë dokumenti, 21  
23 qershor. Dëshmitari tha që ka qenë i përfshirë në unifikimin e  
24 komandave të këtyre njësiteve në qershor të 1998.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Së pari, unë e kam fjalën për

1 pjesën lart, majtas. As vulë, as firmë, as datë. Një gjë është  
2 të thuash që dëshmitari ka qenë i përfshirë dhe tjetër gjë  
3 është të thuash që Shtabi i Përgjithshëm ka lëshuar një vendim  
4 për unifikimin e këtyre njësive. Nëse ju kujtohet nga rasti  
5 i dëshmitarit të fundit, kishim një dokument që kishte  
6 nënshkrim dhe që e morëm nga Facebook-u për këto njësive. Dhe  
7 kjo është problematika. Le të dëgjojmë njëherë çfarë ka për të  
8 thënë dëshmitari, për autenticitetin e një dokumenti që s'ka  
9 as vulë, as firmë, as nënshkrim. Në të majtë --

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Më lejoni të shtoj edhe unë  
11 diçka. Dokumenti po më thonë është printuar nga stacioni i  
12 punës, skrivania e punës së Jakup Krasniqit. Nuk ka asnjë  
13 provë para Gjykatës që ky dokument është jetë printuar që asaj  
14 kohe. Dhe dëshmitari tha qartë që s'e ka parë asnjëherë.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thuhet njëherë që është lëshuar  
16 dhe nga Prishtina këtu, dhe të gjithë e dinë që Shtabi i  
17 Përgjithshëm, të gjithë e dinë që është habi për të gjithë që  
18 Shtabi i Përgjithshëm të ketë lëshuar urdhra nga Prishtina në  
19 atë kohë, kështu që ka problematika sa i takon besueshmërisë  
20 së këtij dokument dhe unë mendoj që për këtë arsye duhet  
21 kundërshtuar.

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju them  
24 dhe një herë, pajtohem deri në një farë mase që duhet të jetë  
25 diçka më specifike për këtë dokument, duhet ta pyesim

1 dëshmitarin çfarë njuh për këtë dokument dhe autenticitetin e  
2 këtij dokumenti. Edhe pastaj bëni pyetjet e mëtutjeshme, por  
3 fillimisht merrni përgjigje për këtë përpara se unë të vendos  
4 nëse do ta pranoj apo jo dokumentin në fjalë.

5 [Mikrofoni çaktivizuar]

6 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
9 Dëshmitar, do të vazhdojmë.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

11 PY. Dëshmitar, shohim dhe një herë dokumentin që është në  
12 ekranin që keni përballë. Ju thatë që keni ndihmuar për  
13 unifikimin e komandave të këtyre njësive në qershor 1998. Ju  
14 lutem, a mund të na përshkruani diçka më shumë se çfarë  
15 përfshirje keni pasur?

16 PË. Po folëm për përfshirjen në unifikimin e njësive. Këto  
17 kam pas më shumë në territorin e Suharekës, ku kanë figuru më  
18 së shumti këto njësitet, Çeliku, Lumi -- Çeliku dhe Lisi. Lumi  
19 jo, Lumi ka qenë në territorin e komunës së Malishevës. Këta  
20 dy njësi i kam unifikuar në territorin e Suharekës ku është  
21 unifiku me së bashku në një shtab lokal që është thirr në atë  
22 kohë shtab lokal i Suharekës. E thënë shkurt në atë kohë, kur  
23 kam ndihmuar që të unifikohen.

24 PY. A u keni dhënë rekomandime apo propozime Shtabit të  
25 Përgjithshëm sa i takon unifikimit të këtyre njësive?

1 PË. Po, sepse prej të parit jam dërguar atje nga Sokol  
2 Bashota, për shkak se këto dy njësi në këtë territor nuk kanë  
3 qëndru mirë. Kanë pas edhe probleme. Për t'i eliminu këto  
4 probleme dhe për t'i unifikuar, atëherë kam shkuar dhe kam  
5 biseduar me të dy njësitë, dhe kemi unifikuar dhe kemi formuar  
6 shtabin lokal të Suharekës.

7 Dhe normalisht pas përfundimit të kësaj kam informuar  
8 drejtorinë operative që janë unifikuar këto njësitë së bashku,  
9 janë formu shtabi lokal i Suharekës.

10 PY. Shtabi i Përgjithshëm i miratoi këto unifikime edhe  
11 propozimet që bëtë ju?

12 PË. Së pari në atë kohë Shtabi i Përgjithshëm nuk është qujt,  
13 është qujt Shtabi Qendror, dhe normal unë i kam informue  
14 drejtorinë operative, faktikisht drejtpërdrejt Sokol Bashotën  
15 që kemi dërgue t'i ndihmojmë se, këtij territori, këtyne  
16 njësive që të unifikohen.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë synoj  
18 sërish që të pranohet ky dokument, megjithatë po tregoj dhe  
19 dokumentin e radhës, në mënyrë që t'i lidh të dyja dokumentet  
20 së bashku.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një dokument  
23 tjetër nga qershori 1998. Dokumenti mban numrin 1D00164,  
24 anglishtja përfundon me ET në fund.

25 PY. Dëshmitar, ju sapo folët për bashkimin e dy njësiteve.

1 Dokumenti që keni përballë, dokumenti që keni përballë, e  
2 njihni?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe njësitet që u përmendën?

5 PË. Po.

6 PY. Këtu flitet për një takim më 26 qershor, ku është marrë  
7 dhe vendimi për shkrirjen, bashkimin e këtyre dy njësiteve. Ju  
8 kujtohet?

9 PË. Po, plotësisht.

10 PY. Keni marrë pjesë ju në takim siç thuhet dhe në dokument?

11 PË. Po, kam marrë pjesë.

12 PY. I njihni emrat e komandantëve, zëvendëskomandantit,  
13 shefit të shtabit dhe emrat e tjerë që përmenden këtu?

14 PË. Po, plot.

15 PY. Pastaj, këto dy njësite ishin në varësinë e Musë Jasharit  
16 siç thuhej në dokumentin që pamë më përpara?

17 PË. Jo, në atë dokument shkruhet tjetër send. Në këtë  
18 dokument është unifikimi i kësaj komande të shtabit lokal të  
19 Suharekës, në qoftë se i referohemi atij dokumenti të  
20 mëhershëm folet për zonën, është më gjerë. Nuk është veç  
21 shtabi lokal i Suharekës, është i Malishevës, është se Lumi  
22 është njësi krejt tjetër dhe territori tjetër është i  
23 Malishevës. Folna për dokumentin e tillë ku, që ishte më  
24 herët.

25 Kurse tash ky dokument është vetëm dokument që flitet për

1 shtabin lokal të Suharekës, që është formu si shtab lokal  
2 PY. Shtabi lokal i Suharekës, a ishte pjesë e zonës së  
3 Pashtrikut?

4 PË. Po.

5 PY. A ishin nën komandën e Musë Jasharit?

6 PË. Po, në atë kohë.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj edhe  
8 një herë që të pranohet dokumenti i mëparshëm me numër  
9 SPOE00232474.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] I njëjti kundërshtim. Nuk i është  
11 treguar thelbi, nuk i është paraqitur thelbi dëshmitarit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
13 1D00164-ET pranohet. Po ashtu pranohet dokumenti SPOE00232474-  
14 ET sipas rregullës 138.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, Gjykatës,  
16 dokumenti i mëparshëm është i pranueshëm [Korrigjim i  
17 përkthyesit: dokumenti është pranuar që më herët], 1D00164.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, keni të  
19 drejtë, është pjesë e provave gjyqësore ky dokument.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër  
21 SPOE00232474 deri në 00232474 bashkë me përkthimin në anglisht  
22 merr numrin e provës materiale P01381 dhe është i klasifikuar  
23 si konfidencial.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik.

- 1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
- 2 Riklasifikojeni si publik.
- 3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.
- 4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj t'ju tregoj disa shënime
- 5 që janë përafërsisht në të njëjtën periudhë kohore. Është
- 6 prova materiale P00075. Anglishtja përfundon me ET në fund.
- 7 Faqja që na nevojitet është 9270 ose përndryshe faqja 24 në
- 8 versionin në PDF.
- 9 PY. Dëshmitar, ju lutem shihni lart majtas në fillim të
- 10 faqes. Dhe më poshtë thuhet, "Breshanc". Për kë bëhet fjalë
- 11 këtu kur thuhet "Breshanc"? Në fund fare. "Agim, Breshanc",
- 12 për kë bëhet fjalët?
- 13 PË. Agim është emri, kurse Breshanc është emri i fshatit.
- 14 Breshanc aty ku ka qenë edhe komanda e shtabit lokal të
- 15 Suharekës, faktikisht, edhe Brigadës 123.
- 16 PY. Siç e pamë dhe në dokumentin e mëparshëm, Agim Kuqi ishte
- 17 shefi i shtabit atje, apo jo?
- 18 PË. Po. Në shtabin lokal të Suharekës.
- 19 PY. Lart, në dokument, duket sikur thuhet që është
- 20 shkruajtur:
- 21 "Bisedë me Bislumin".
- 22 Është ky lloj informacioni që ju i jepnit njësiteve për
- 23 sa i përket strukturës, për shembull?
- 24 PË. Po.
- 25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë, ju lutem që në ekran të



1 vendoset SPOE00225796.

2 PY. Atëherë, së pari, duke parë pjesën e poshtme të këtij  
3 dokumenti, a e njihni emrin në fund të faqes?

4 PË. Po.

5 PY. A është e saktë që ai ka qenë komandanti i shtabit lokal  
6 të Suharekës në atë kohë? Data është 1 korrik.

7 PË. Po.

8 PY. Kjo është kërkesë për tabela të veturave të UÇK-së. A  
9 është e saktë që disa automjete të UÇK-së kishin në fakt  
10 tabela specifike?

11 PË. Po, është e saktë.

12 PY. Dhe në fjalinë e fundit kërkohet gjithashtu që të lejohen  
13 edhe dy tabela për policinë ushtarake. Ka patur dhe tabela të  
14 posaçme apo specifike për policinë ushtarake gjithashtu?

15 PË. Nuk më kujtohet. E di që ka pas tabela që janë përdorur si  
16 të, me shenjat e UÇK-së, po për policinë ushtarake veçan nuk e  
17 di. Nuk më kujtohet.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar, kërkojmë të pranohet  
19 ky dokument.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kam të njëjtin kundërshtim që  
21 shpreha sot paradite.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe unë jam, shpreh kundërshtimin  
24 tim pasi dokumenti është njësoj si ai për të cilin unë  
25 shprehem.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
2 SPOE00225796 pranohet pasi ka pranuar standardin *prima facie*  
3 të rregullës 138.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Thjesht për të  
5 konfirmuar për procesverbalin që duhet të pranohen të dyja  
6 faqet e dokumentit.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, a mund të kalojmë tek faqja e  
8 dytë? Po. Po, është faqja e pasme në këtë dokument, faqja e  
9 dytë.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kundërshtojmë përdorimin e  
11 faqes së dytë sepse aty thjesht janë bërë disa shënime ose  
12 shkarravina të themi, por se kush i ka bërë ato nuk e dimë,  
13 nuk është përcaktuar ende. Nuk dihet.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet  
15 kundërshtimi juaj, rrëzohet ai.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, dokumenti  
17 me ERN SPOE00225796 deri në SPOE00225797, si dhe përkthimi i  
18 tij në gjuhën angleze do të marrin numrin e provës P01382, me  
19 klasifikimin konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, përpara pak kohe ne pamë një dokument në të  
24 cilin emërohej Mustafa Jashari si komandant në shtabin lokal  
25 të Malishevës. Përgjegjësitë e tij a ishin më të zgjeruara për

1 të përfshirë dhe tre njësitë që janë përmendur në atë vendim,  
2 Çelikun, Lumin dhe Lisin?

3 PË. Nji përmirësim. Nuk është zgjedh komandant i shtabit  
4 lokal të Malishevës. Se shtabi lokal i Malishevës është  
5 tjetër. Musë Jashari është zgjedh komandant i shtabit,  
6 faktikisht, i komandës së zonës operative të Pashtrikut. Zona  
7 e -- kur thoni Malishevës, lokal, është tjetër, është njësi  
8 lokale shumë më poshtë asaj që është zgjedhur.

9 PY. Dhe përafërsisht, në ç'kohë ka kryer këto përgjegjësi në  
10 zonën e Pashtrikut ai?

11 PË. Po prej kësaj kohës kur është emënuar deri në nëntor 1998.

12 PY. Përafërsisht që kur e keni ditur ju që ai ka patur këto  
13 funksione apo detyra apo që ishte emëruar?

14 PË. Kjo pasi është emëruar. Faktikisht, do të them në fund të  
15 qershorit apo në fillim të korrikut.

16 PY. Dëshiroj që t'u kthehem vizitave që ju keni bërë në  
17 njësite të ndryshme në verën e vitit 1998. Si një çështje të  
18 përgjithshme, në qershor-korrik kur juve ju është caktuar  
19 detyra për të shkuar tek këto njësite për të ndihmuar me  
20 organizimin e tyre, nga e dinit ju se në cilat fshatra duhet  
21 të shkonit pra ku ishin këto njësite?

22 PË. Po jap një shembull. Në fillim kur folëm, qershor,  
23 shembull po marr, përveç kësaj që edhe shpjeguar më herët,  
24 unifikimin e shtabit lokal në Suharekë. Kam marrë pjesë  
25 menjëherë mbas saj kam shku në unifikimin e njësive dhe në

1 shtabin lokal të Prizrenit. Në atë kohë, në qershor, në fund,  
2 në fakt, të qershorit, kanë ardhur përfaqësues të këtij  
3 regjioni, në Shtab Qendror dhe kanë biseduar me Sokol  
4 Bashotën. Sokol Bashota më ka thirrur dhe më ka udhëzuar që të  
5 shkoj në këtë territor, t'i ndihmoj në organizimin dhe  
6 organizimin e njësive në këtë territor, dhe normalisht gjatë  
7 kësaj të formohet dhe shtabi lokal në Prizren.

8 Domethënë, faktikisht, kur je në këto territore kanë shku  
9 ose kanë ardhur përfaqësuesit e këtyre shtabeve lokale në  
10 shtab që kanë kërkuar, ose gjatë kalimit në, prej shtabit prej  
11 një zone në zonën tjetër.

12 PY. Ju thatë që ka qenë rreth fundit të qershorit kur keni  
13 vajtur në Prizren për të ndihmuar. A ka patur forca serbe të  
14 pranishme në zonën rreth Drinit në atë kohë [korrigjim i  
15 përkthyesit: Vrrinit në atë kohë]?

16 PË. Po, ka pasur. Rreth territorit të Vrrinit, jo brenda në  
17 territorin e Vrrinit.

18 PY. Pra, e kishin rrethuar atë, ose rreth e qark. Por jo  
19 brenda në zonë.

20 PË. Jo brenda në zonë.

21 PY. Dhe përafërsisht në cilën zonë gjeografike, cila zonë  
22 gjeografike mbulohej nga kjo zonë?

23 PË. Zona gjeografike e saj mbulohet, territori i Vrrinit  
24 është në pjesën, faktikisht, juglindje të Prizrenit.

25 PY. Ju keni thënë më parë që shtabi lokal atje ishte, bazohej

1 në Jeshkovë. A mund të na shpjegoni pak ato ndërtesat që ishin  
2 rreth e rrotull edhe zonën, pra, rreth ndërtesës kryesore?

3 PË. Shtabi lokal pasi jam shku edhe është formue, dhe komanda  
4 e saj është vendosur në fshatin Jeshkovë, dhe është vendosur  
5 në një shtëpi private. Përveçse shtëpisë private, ka qenë edhe  
6 shkolla, shkolla e vjetër, aty ka qenë edhe policia,  
7 faktikisht, edhe njësitë ushtarake, grupit të shtabit lokal  
8 në, vendosur.

9 PY. A kishte polici ushtarake atje në atë kohë?

10 PË. Po, ishte një, kishin formuar ata një skuadër të tillë.

11 PY. Ku e kishin bazën ata?

12 PË. Ishte në shkollë, të Jeshkovës.

13 PY. A e mbani mend se kush ishin komandanti dhe  
14 zëvendëskomandanti i këtij ekipi, skuadre të policisë  
15 ushtarake?

16 PË. Komandant ka qenë i kësaj njësie Selajdin Berisha.  
17 Zëvendësi nuk më kujtohet tash.

18 PY. Ju keni shpjeguar që Remzi Ademi u bë komandanti i  
19 shtabit lokal atje. A kishte pseudonim ose nofkë ai?

20 PË. Po. Remzi Ademi është emënie, ka qenë komandant i shtabit  
21 lokal, dhe pseudonimi i tij ka qenë Petriti, njëjtë si edhe  
22 grupi që ka qenë, e ka pas emrin Petriti. Sikur ashtu që e  
23 patëm emra të njësive të tjera, Lumi, Lisi etj. ashtu edhe  
24 njësitë brenda Prizrenit e ka pas Petriti.

25 PY. Më parë keni shpjeguar komandantin në Leskovec, ka qenë

- 1 Naser Berisha, ndërsa në Biliq [fonetikiisht] ka qenë Zafir  
2 Berisha. Kujt i raportonin ata pra, si strukturë?  
3 PË. Të dy që përmendët janë komandantët e batalionit,  
4 Batalionit të 1-rë dhe të 2-të. Batalionit të 1-rë ka qenë  
5 Naseri, dhe në komandë në Leskovec, kurse i 2-ti Zafir Berisha  
6 në Billushë. I ka raportonin komandantit të shtabit lokal  
7 Remzi Ademit.  
8 PY. Është Remzi Ademi në Jeshkovë?  
9 PË. Po, me komandë me bazë në Jeshkovë.  
10 PY. Cilës, në cilën brigadë u vënë këta, këto njësite, u bënë  
11 pjesë të saj, pra cilës brigadë?  
12 PË. Më vonë kur u formuan brigadat, u bë Brigada 125.  
13 PY. A mbani mend ndonjë nga ata persona që në atë kohë  
14 punonin tek logjistika?  
15 PË. Po.  
16 PY. A mund të na thoni se kë mbani mend?  
17 PË. Si zëvendëskomandant për logjistikë ka qenë Selim  
18 Krasniqi, kurse dhe ndihmësi i tij ka qenë Xhemshit Krasniqi.  
19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të shfaqet në ekran ju lutem  
20 dokumenti P00070?  
21 PY. A i njihni vendndodhjet ose vendet të cilave u referohet  
22 ky dokument?  
23 PË. Vendndodhjet, po. Por dokumentin për herë të parë po e  
24 shoh.  
25 PY. A keni qenë i përfshirë në përpjekjen që u bë për

1 unifikimin apo bashkimin e komandës në këtë zonë?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të na shpjegoni përfshirjen që keni patur ju  
4 personalisht?

5 PË. Unë personalisht në këtë territor kam punuar njëjtë si në  
6 territore të tjera për të unifikuar grupet, për të unifikuar  
7 njësitet të cilat kanë qenë në atë territor, që të mos  
8 krijojnë -- në këtë territor është punuar që të formohet  
9 Batalioni i 2-të në zonën e Pashtrikut, faktikisht, në zonën e  
10 Rahovecit. Dhe i kemi, kam punuar që të unifikohen të gjitha  
11 këto në këto fshatra, këto njësitet të cilat janë, kanë qenë  
12 në atë kohë. Dhe janë kyç në një shtab rajonal i cili është  
13 qujt shtabi -- siç janë quajt shtabet lokale dhe të tjerat  
14 shtabet, për shembull të Suharekës, Prizrenit, ashtu dhe  
15 Rahovecit, dhe pastaj këto janë formue, kanë dalë nën formimin  
16 e mëtejshëm me brigadat.

17 Po folim në atë kohë, unë këtë shtab, kam punue në këtë  
18 territor që të unifikohen këto njësitet.

19 PY. Dhe këto njësitet, sa i përket strukturës së komandës, u  
20 bënë pjesë e çfarë strukture?

21 PË. Këto u bënë pjesë e si, Batalioni i 2-të i shtabit lokal  
22 të Rahovecit. Pastaj Brigadës 124.

23 PY. Binak Gashi që përmendët këtu, a është një nga oficerët  
24 që erdhi me ju në Kosovë nga Shqipëria?

25 PË. Po, një nga oficerët që ka hyrë së bashku në të njëjtën

1 kohë kur kemi hyrë së bashku.

2 PY. Dhe ai ishte i bazuar në Drenovc, apo jo? Ose iu caktua  
3 Drenovci si zonë.

4 PË. Po, njëjtë edhe ai. Është bazu, dalë në Drenovc, për  
5 shkak se ai ishte i territorit të Gremnikut edhe thoshin, të  
6 atij territori, lindur. Edhe i ka njoftur ata njerëz, dhe ata  
7 kanë njoftur, dhe ka qenë ma lehtë ai të ndalet aty dhe të  
8 punon në unifikimin e atyne njësive ose grupeve të këtyne  
9 fshatrave që të formohet ky Batalioni i 2-të.

10 PY. Mund të shikojmë që ky dokument i referohet takimit të  
11 Shtabit të Përgjithshëm të mbajtur në 30 qershor. Ju keni qenë  
12 në atë takim?

13 PË. Jo.

14 PY. A ia kishe dhënë rekomandimet ose propozimet tuaja dikujt  
15 në lidhje me këtë ristrukturim?

16 PË. Po këtë ristrukturim kur veç kemi qenë dhe ma herët në  
17 territorin e Rahovecit, faktikisht, në këtë territor. Kam  
18 dhënë këto propozimet dhe këtyne njësive, por njashtu kam  
19 raportu atëherë edhe drejtorisë operative, Sokol Bashotës, se  
20 këto mund të afrohen ose të bëhet një njësi e dytë, ose  
21 batalion i dytë në kësaj, këtij shtabi lokal.

22 Se unë në atë kohë para saj veç kam shkuar në territorin  
23 e Vrrinit në Prizren, kështu që nuk kam qenë ato ditë aty.

24 PY. Atëherë, ju keni konfirmuar në të shkuarën dhe këtu i  
25 referohem materialit P01356, që është dëshmia jua në çështjen



1 Sainovic, në faqen 6017, që deri në mes të korrikut UÇK-ja  
2 kishte nën kontroll përafërsisht pak a shumë 50 për qind të  
3 territorit të Kosovës dhe nuk mund të konfirmonit këtë  
4 përqindje. A keni njohuri për termin "zonë e lirë"?  
5 PË. Po, sigurisht, po. Zonë e lirë është në cilën, varet, ajo  
6 zonë në të cilën kontrollon ato njësitë ose ai grup.  
7 Faktikisht, në zonë e lirë te ne është qujt ato zona ku është  
8 kontrolluar nga UÇK-ja ose fakti ku s'ka pas forca serbe.  
9 PY. A ka patur në Kosovë një zonë së cilës i referoheshit si  
10 "zona e lirë", në atë kohë, pra në qershor dhe gjysmën e parë  
11 të korrikut?  
12 PË. Po, qershori, për shembull, pjesa më e madhe ka qenë edhe  
13 Drenica, pjesë e madhe e Pashtrikut, edhe Dukagjini. Në shumë  
14 vende ka pasur, domethënë, të cilat kanë qenë zonat e lira.  
15 PY. Në zonën e lirë në Pashtrik, a ka patur një vend që mund  
16 të konsiderohej në atë kohë si qyteti kryesor, të themi, i  
17 asaj zone?  
18 PË. Po, si qytet ose komunë, ka qenë Malisheva, e cila ka  
19 qenë zonë e lirë edhe ka qenë në kontrollin e plotë të  
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.  
21 PY. Ju keni shpjeguar që jeni njoftuar që u caktuat ose u  
22 emëruat shef i drejtorisë operative. Përafërsisht, kur ju kanë  
23 informuar në lidhje me këtë çështje?  
24 PË. Ka qenë diku mesi i korrikut, faktikisht, mund të them,  
25 mund të themi tri ditë apo katër ditë para se të fillon

1 ofensiva në Rahovec.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që në ekran të shfaqim  
3 një provë me emërtimin SPOE00223376, faqja 2 në gjuhën  
4 angleze. Dhe në gjuhën shqipe është pjesa e sipërme e kolonës  
5 numër dy, ose shtyllës numër dy të tekstit.

6 PY. Do ta lexoj me zë. Ju po i përgjigjeni një pyetjeje dhe  
7 aty thoni:

8 "Më vonë e kuptova shumë qartë këtë çështje, pasi hymë në  
9 Kosovë dhe pas takimit me Shtabin e Përgjithshëm që patëm në  
10 qershor dhe ku edhe unë u pranova si anëtar i Shtabit të  
11 Përgjithshëm dhe si Shef i Drejtorisë Operative në 15 qershor  
12 1998. Në atë kohë, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm ishin  
13 Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Sokol Bashota, Rexhep Selimi,  
14 Jakup Krasniqi dhe Lahi Brahimaj. Të gjithë këta më pranuan si  
15 anëtar të Shtabit të Përgjithshëm dhe Shef të Drejtorisë  
16 Operative pranë Shtabit të Përgjithshëm.

17 "Atë ditë, ka udhëhequr Jakup Krasniqi. Në atë mbledhje u  
18 njoftova me të gjithë anëtarët e Shtabit me funksionet që ata  
19 kishin, dhe më njoftuan se komandant i Shtabit të Përgjithshëm  
20 të UÇK-së është Azem Sylja. Por emri i tij duhej të mbahej  
21 sekret për shkak të veprimit të tij jashtë Kosovës.

22 PË. Qartë.

23 PY. Në bazë të kësaj dëshmie, në fakt duhet të jetë 15 korrik  
24 jo 15 qershor 1998, është e saktë kjo? Përveç kësaj --

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. -- po përveç këtij ndryshimi kjo gjë që keni thënë këtu a  
2 është e saktë?

3 PË. Po, e saktë [E padëgjueshme].

4 PY. Pra, në këto kohë jeni informuar dhe për Azem Sylën dhe  
5 që ju është thënë që kjo duhej mbajtur sekret, a është e saktë  
6 kjo?

7 PË. Po, e saktë është.

8 PY. Ku është mbajtur ky takim me anëtarët e Shtabit të  
9 Përgjithshëm dhe fakti që ata ju pranuan juve si shef të  
10 drejtorisë operative?

11 PË. Më kujtohet diku, mund të ishte, kemi qenë në një shtëpi  
12 private në regjionin e Malishevës, por saktë nuk e di.

13 PY. Dhe në momentin që ju jeni emëruar, a patët diskutime me  
14 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm për mënyrën se si do të  
15 organizohet drejtoria operative?

16 PË. Kemi folur pak aty, por jo dhe q'aq shumë, s'kemi pas  
17 kohë të bisedojmë për këto çështje. Se për arsye se menjëherë  
18 pas kësaj u dasht që të shkojmë në territorin e Dukagjinit ku  
19 e kishim takimin me komandantin e zonës së Dukagjinit.

20 PY. Cilat ishin ato tema që ju diskutuat në atë kohë?

21 PË. Atëherë është diskutu për zhvillimin e saj. Faktikisht,  
22 edhe se si po shkon unifikimi i shtabeve lokale në territor,  
23 domethënë nëpër zonat ose nënzonat në atë kohë, dhe si po  
24 shkon zhvillimi i riorganizimit të mëtutjeshëm i Ushtrisë  
25 Çlirimtare të Kosovës. Kjo ishte në atë kohë si temë kur u

1 diskutuan.

2 PY. A keni, diskutuat se kush do të ishte pjesë e kësaj  
3 drejtorie operative?

4 PË. Jo, përveç asaj që veç që isha i vendosur në këtë  
5 drejtori. Së bashku me mu ka qenë edhe Agim Qelaj. Për  
6 momentin kemi qenë veç dy si eprorë, me ndihmën që do e kam  
7 pas edhe nga, edhe Rexhep Selimi edhe Sokol Bashota në atë  
8 kohë. Mirëpo nuk kemi pas edhe të tjerë anëtarë, dhe atyre u  
9 është thanë që ngadalë të formohen ose të punojnë në ato që të  
10 bijnë edhe eprorë të tjerë që të plotësohet kjo drejtori.

11 PY. Në qershor dhe korrik të vitit 1998, cila ka qenë  
12 procedura për autorizimin e operacioneve të UÇK-së?

13 PË. Në përgjithësi, për operacionet është dhënë së pari duhet  
14 dasht njësitë të jenë të gatshme, të përgatitun në mënyrë  
15 operative, në qoftë se njësitë janë të përgatitur operative  
16 edhe të pajisur mirë dhe të furnizuar me logjistikë të  
17 mjftueshme, atëherë ka mujt të ecë në operacionet. Përndryshe  
18 Shtabi i Përgjithshëm ka mund të japë ose të lejojë  
19 operacionet të cilat janë operacionet operative dhe  
20 strategjike. Kurse ajo të ulëtat ose më taktike më të vogla,  
21 ato e kanë pas, kanë pas komandantët e zonave simbas situatës  
22 së vet, të veprojnë në territorin e vet.

23 PY. Na keni thënë që shumë shpejt pasi u emëruat, ju vajtët  
24 në Dukagjin. Ku në Dukagjin vajtët si fillim?

25 PË. Si fillim kemi qenë në takime me komandantin e zonës së

- 1 Dukagjinit, komandantin Ramush Haradinaj. Jemi takuar në
- 2 Jabllanicë, fshati Jabllanicë.
- 3 PY. A ka patur persona të tjerë që kanë udhëtuar me ju në atë
- 4 takim?
- 5 PË. Po. Nga anëtarët e shtabit, me anëtarët e shtabit kemi
- 6 shku bashkë atje.
- 7 PY. Kush ishte me ju nga Shtabi i Përgjithshëm?
- 8 PË. Bashkë kemi qenë unë, ka qenë Jakup Krasniqi, ka qenë
- 9 Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Lahi Brahimi.
- 10 PY. Këta persona që sapo përmendët, morën të gjithë pjesën në
- 11 takimin me komandantin e zonës në Jabllanicë?
- 12 PË. Po, atë ditë.
- 13 PY. Ju thatë që edhe Lahi Brahimaj ishte një nga personat që
- 14 udhëtoi me ju. A e dini se çfarë funksioni kishte ai në atë
- 15 kohë në Shtabin e Përgjithshëm?
- 16 PË. E di që në atë kohë ka qenë në Shtabin e Përgjithshëm,
- 17 por çka mbaj mend mbasandej ka qenë për drejtorinë e
- 18 financave. Por çka ka qenë ma herët, nuk e di.
- 19 PY. Ju keni qëndruar gjatë gjithë kohës që u mbajt takimi në
- 20 Jabllanicë?
- 21 PË. Po. Dhe përveç asaj që kam qëndru gjatë gjithë kohës që
- 22 është mbajt takimi, po edhe pas përfundimit të takimit, unë
- 23 kam vazhdu të qëndroj në zonën e Dukagjinit për t'u njoftuar
- 24 me atë zonë dhe situatën në atë zonë. Dhe kam qëndruar po disa
- 25 ditë mbrapa në atë territor.

1 PY. Çfarë u diskutua në atë takim? Dhe më pas do të  
2 diskutojmë çfarë ndodhi pasi udhëtua në pjesën tjetër të  
3 Dukagjinit.

4 PË. Në atë takim kemi biseduar në atë kohë për çështjet e  
5 furnizimit, logjistikës, zhvillimit të Ushtrisë Çlirimtare të  
6 Kosovës, zgjerimin e saj, dhe forcimin e saj. Sa më kujtohet,  
7 këto ishin temat të cilat ne në atë kohë i kemi diskutuar.

8 PY. Ju po tregonit për atë që ndodhi pas takimit. Ju lutem,  
9 vazhdoni na thoni, çfarë bëtë pas këtij takimi?

10 PË. Pas takimit, kam vazhdu me komandantin e zonës, për t'ju  
11 njoftuar me zonën, dhe me arritjen e, faktikisht në komandën e  
12 zonës të Dukagjinit në Gllogjan. Pastaj së bashku me ish-  
13 shefin e shtabit të asaj zone që ishte Sali Veseli kam  
14 vizituar njësitë në territorin e Dukagjinit, në pjesën,  
15 faktikisht, Gllogjan edhe pjesën e Jabllanicës, Lugut të  
16 Baranit, edhe të gjitha këto territoreve. Dhe normalisht edhe  
17 vizitë edhe territorit të Rekës së Keqe që ishte në anën e  
18 tjetër, ma afër kufirit me Shqipërinë.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj t'ju tregoj disa  
20 dokumente. Dokumenti i parë mban numrin U001-5562. Anglishtja  
21 përfundon me ET-1.

22 PY. Dokumenti mban datën 27 korrik. A është e vërtetë që kjo  
23 është shkurtimisht pas vizitës suaj në Dukagjin?

24 PË. Kjo është normalisht shkurtimisht prej vizitës kur kam  
25 qenë, që është shumë para këtij dokumenti.

1 PY. Të sqarojmë dhe një herë përgjigjen tuaj. Ju keni shkuar  
2 në mes të korrikut në Dukagjin, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe ky dokument mban datën 28 korrik. A i takon që të  
5 jetë pak kohë pasi të keni qenë ju atje?

6 PË. Po, mund të -- po. Jo bash pak kohë, por pak një kohë pak  
7 më shumë, se duhet të dihet se unë me të 19 veç kam qenë në  
8 territorin e Rahovecit, do të thotë nja nëntë ditë para --  
9 mbrapa. Dhe këto ndodhitë janë sigurisht, ka raportue, ndodhi  
10 që kanë ndodh prej, thuaja, 19 apo 20 deri më 28 të atij  
11 muaji, dhe atij viti. Kjo mund të jetë.

12 PY. Shohim përmbajtjen e dokumentit për të parë nëse  
13 përputhet me atë që keni vërejtur dhe ju kur keni qenë atje.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë pak më poshtë  
15 në faqen numër 1.

16 PY. Te paragrafi i dytë nga fundi, flet për tri brigada, në  
17 prapavijë janë formuar -- katër, paragrafi i katërt nga  
18 poshtë. Thuhet që në prapavijë janë formuar tri brigada  
19 sulmuese. A ka qenë vërtetë kështu në atë kohë?

20 PË. Po, në atë kohë kur kam qenë unë veç kanë qenë këto  
21 brigadat duke u formuar, duke u strukturuar.

22 PY. A ndihmuat ju për këtë, a patët ndonjë përfshirje?

23 PË. Po, pak. Nga aspektet e komandës se si organizohet  
24 komanda.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kalojmë tek faqja 2, ju lutem.

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Lawson

Faqe 56

1 PY. Shohim këtu te paragrafi i parafundit, ku thuhet kemi  
2 formuar policinë ushtarake. A është e saktë, a e vrojtuat edhe  
3 ju një gjë të tillë asokohe?

4 PË. Po, po. Është e saktë.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
6 pranohet dokumenti si provë gjyqësore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk u  
11 paraqitën kundërshtime. Dokumenti me numër U001-5562-ET-1,  
12 bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe, pranohet. Ju lutem,  
13 jepni numrin përkatës.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, numri  
15 është U001-5562 dhe 001-5563, me përkthimin në gjuhën angleze.  
16 Merr numrin e provës materiale P01383, dhe klasifikimi është  
17 konfidencial.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë një dokument publik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
20 Riklasifikojeni.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani dëshiroj që të shikojmë  
22 dokumentin me numër SPOE00232227.

23 PY. A përputhet kjo me atë që keni ditur dhe ju sa i takon  
24 Sali Veselit në zonën e Dukagjinit?

25 PË. Po, ka qenë në këtë detyrë.



1 PY. A kishte ndonjë rol tjetër apo ndonjë rol paralel përveç  
2 faktit që ishte shefi i sektorit të operatives?

3 PË. Në atë kohë ishte dhe i shtabit si oficer, shef i shtabit  
4 të zonës, nënzonës, faktikisht, të Dukagjinit.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet ky dokument  
6 si provë gjyqësore.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të njëjtin kundërshtim kam. Ky  
8 është një dokument që është marrë nga një kompjuter pune, nuk  
9 ka asnjë provë se kur është përgatitur ky dokument dhe kush e  
10 ka përgatitur këtë dokument.

11 Dhe as nuk i është bërë ndonjë pyetje dëshmitarit a e  
12 njeh këtë dokument.

13 Gjithashtu dëshiroj t'ju them që në krye të dokumentit  
14 nuk përmendet, nuk ka numër protokolli dhe sipas datës është o  
15 1998, o 1999, që tregon qartazi që ky dokument mund të jetë  
16 përgatitur dhe më 1999.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I bashkohem kundërshtimit, e për  
18 të njëjtat arsye që kundërshtova më përpara. Dëshmitarit nuk  
19 po i tregohet thelbi i këtij dokumenti, ndonëse ky sipas  
20 Prokurorisë, ky dokument i atribuohet Shtabit të Përgjithshëm.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dokumenti ka  
22 datën e takimit kur është marrë ky vendim dhe dëshmitari ka  
23 konfirmuar se ka pasur dijeni për pozitat e personit në fjalë  
24 në atë kohë.

25 [Anëtarët e Trupit Gjyqësor këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
2 rrëzohet. Dokumenti SPOE00232227 pranohet dhe merr numrin  
3 përkatës.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dëshiroj t'ju pyes  
5 sepse dokumenti është me dy faqe, por faqja e dytë është bosh.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
7 vetëm faqen e parë.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti SPOE00232227  
9 bashkë me përkthimin në gjuhën angleze merr numrin e provës  
10 P01384, dhe ka klasifikimin konfidencial.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë një dokument publik.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thatë si  
13 publik?

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
16 riklasifikojeni si dokument publik.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të shfaqet në ekran tani  
18 dokumenti me numër U000-2579.

19 Së pari, shohim në fund të faqes që të shohim pjesën ku  
20 është firma.

21 PY. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin në këtë faqe?

22 PË. Po.

23 PY. Ky dokument a përputhet dhe me atë që dinit ju sa i takon  
24 zonës së përgjegjësisë që kishte Shemsedin Cekaj?

25 PË. Po, kur kam vizituar këtë zonë.

1 PY. Dhe për rolin e Sali Veselit, që e diskutuam, në fakt, në  
2 dokumentin pararendës, kështu?

3 PË. Po, këtu shifet, i drejtohet kryeshefit të shtabit  
4 operativ, ashtu edhe si e ceka.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet dhe ky  
6 dokument.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
11 kundërshtime. Dokumenti U000-2579 pranohet. Ju lutem, t'i  
12 jepni numrin përkatës.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me  
14 përkthimin në gjuhën angleze do të marrë numrin P01385. E ka  
15 klasifikimin konfidencial.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë një dokument publik.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
18 Riklasifikojeni.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do lutesha të shfaqej në  
21 ekran materiali me numër U000-2555.

22 PY. Fillojmë nga fundi i faqes. Dëshmitar, e njihni  
23 nënshkrimin?

24 PË. Po.

25 PY. A përputhet kjo me atë që dinit dhe ju sa i takon rolit

1 të Faton Mehmetaj asokohe?

2 PË. Po.

3 PY. E takuat kur bëtë vizitën tuaj të parë në Dukagjin?

4 PË. Po.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
6 pranohet dhe ky dokument si provë gjyqësore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtime? Nuk shoh të ketë kundërshtime. Në rregull.  
9 Dokumenti U000-2555 pranohet.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me  
11 përkthimin në gjuhën angleze do të marrë numrin P01386. Dhe  
12 klasifikimin e ka publik.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të vendosni në ekran  
14 tani materialin me numër U002-2562. Për këtë dokument, ET  
15 është para numrit.

16 PY. Shohim emrin këtu Faton Mehmetaj, për të cilin sapo  
17 folëm. Ky i drejtohet komandantit të njësisë të shpejta me  
18 qendër në Irzniq. Çfarë njësi ishte ky?

19 PË. Gjatë vizitës sime kur kam vizitu në Irzniq ka qenë  
20 njësi i reagimit të shpejtë që ka udhëhequr atëherë Togeri,  
21 i cili ka qenë në komandën e komandantit të zonës operative të  
22 Dukagjinit.

23 PY. Si e ka pasur emrin e plotë Togeri?

24 PË. Togeri në, emrin e plotë, Idriz Balaj.

25 PY. Ky njësit, pra njësi i shpejtë, a kishte ndonjë emër,

1 domethënë njësitë i ndërhyrjes së shpejtë, a kishte ndonjë  
2 emër me të cilin njihej?

3 PË. Po, më vonë është qujt dhe Shqiponjat e Zeza.

4 PY. A shkuat ju në Irzniq gjatë vizitës që bëtë në Dukagjin  
5 në korrik?

6 PË. Po.

7 PY. Atje u takove me Togerin?

8 PË. Po, aty jam taku.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
10 pranohet ky dokument.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
12 [Përkthim] Nuk shoh të këtë kundërshtime. Dokumenti U002-2562  
13 pranohet.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me  
15 përkthimin në gjuhën angleze merr numrin P01387, dhe  
16 klasifikimi është konfidencial.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë dhe dokument publik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

19 Riklasifikojeni si dokument publik.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do kërkoja të shfaqej në  
21 ekran materiali me numër U000-2573. Edhe në këtë rast ET është  
22 para numrit për anglishten.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na  
24 jepni numrin ERN të shqipes?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po besoj se ka të njëjtin numër,

1 U000-2573.

2 Në rregull. Po afrohet pushimi i drekës, kështu që mund  
3 ta lëmë këtë, por shohim një dokument tjetër. Shohim  
4 dokumentin U001-4546. Anglishtja fillon me ET.  
5 PY. Të fillojmë nga fundi. A e njihni nënshkrimin që shohim  
6 këtu?

7 PË. Po.

8 PY. Po personin që përmendet në këtë dokument, Qerim  
9 Kelmendin, e njihni?

10 PË. Po. Ka punuar në logjistikë në Shqipëri.

11 PY. Në nivel të Shtabit të Përgjithshëm?

12 PË. Po, ky ka qenë së bashku me të tjerët të cilët i kam  
13 njoftur, ka qenë në kuadër të bazës logjistike, faktikisht, në  
14 logjistikën e UÇK-së. Nuk di për çka autorizim mund t'i jepte  
15 nënzona, q'atë, të furnizohej, veç kur ka qenë ky si oficer i  
16 logjistikës.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
18 pranohet ky dokument si provë gjyqësore.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
20 kundërshtime? Me sa shoh nuk ka kundërshtime. Në rregull.  
21 Dokumenti U001-4546 pranohet.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me  
23 përkthimin në gjuhën angleze merr numrin e provës P01388, dhe  
24 ka klasifikim konfidencial.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të rifiklasifikohet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

2 Rifiklasifikojeni si dokument publik.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do të kërkoja të shfaqej në  
4 ekran materiali me numër U000-2575. Edhe në këtë dokument ET  
5 është para numrit.

6 PY. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

7 PË. Po.

8 PY. A e njihni kush është Fan Nol Bardhi që përmendet në këtë  
9 dokument?

10 PË. Po, e njof. Njëjtë, njëjtë ka punu në logjistikën në  
11 Shqipëri, së bashku me Qerim Kelmendin në territorin e Bajram  
12 Currit.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që  
14 edhe ky dokument të pranohet si provë gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
16 kundërshtime? Me sa shoh nuk ka kundërshtime. Në rregull.  
17 Dokumenti U000-2575 pranohet.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti bashkë me  
19 anglishten do të marrë numrin P01389, dhe ka klasifikimin  
20 konfidencial.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
22 Riklasifikojeni si dokument publik.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Para pushimit do shohim dhe një  
25 dokument tjetër. Është dokumenti SPOE00232246. Ju lutem, tek

1 faqja tjetër. Po, këtu.

2 PY. Dëshmitar, e njihni emrin e personit këtu, Burim

3 Mormellaku, në kllapa, Dervishi?

4 PË. Po.

5 PY. A mund ta në përshkruani çfarë roli kishte ky person?

6 PË. Sa më kujtohet, në atë kohë, ka qenë një lloj korrieri,

7 me të cilët, kemi pas, domethënë mbartin, ose nevojën, se ka

8 mbajt prej Shqipërisë në Kosovë dhe prej Kosovës në Shqipëri.

9 Po këtë dokument, këtë dokument po e shoh për herë të parë.

10 Thuhet, "për sektorin e furnizimit". Nuk e di këtë.

11 PY. A ka pasur ndonjë rol ai në logjistikë apo në aspektet

12 logjistike?

13 PË. Nuk e di, jo. E di që si lloj si korrieri ka qenë, a për

14 logjikë nuk e di çfarë [E padëgjueshme].

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që  
16 është momenti më i përshtatshëm për të bërë pushimin e drekës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
18 erdhi momenti për pushimin e drekës që zgjat një orë e gjysmë.

19 Do ktheheni në orën 14.30, dhe kemi dhe dy orë dhe do të  
20 përfundojmë. Faleminderit për informatat e deritanishme. Ju  
21 urojmë një drekë të këndshme.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Rifillojmë në orën 14.30.



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Lawson

Faqe 65

1 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

2 --- Seanca rifillon në orën 14.31

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
4 Seancës, mund të sillni në sallë dëshmitarin.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht për të planifikuar, do të  
6 bëjmë një pushim deri në 4.30 apo do të vijojmë?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta  
8 diskutonim, po mendoj që duhet të bëjmë një pushim prej dhjetë  
9 minutash.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se  
12 erdhët sërish në sallë, Dëshmitar. Tani do të vijojmë. Dhe siç  
13 e thashë, do të vazhdojmë me këtë seancë prej dy orësh. Pas  
14 një ore, do të bëjmë një pushim prej dhjetë minutash dhe do të  
15 vijojmë pastaj deri në orën 4.30.

16 Ju lutem vëmendjen t'ia jepni Prokurores. Faleminderit.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

18 PY. Mirëdita.

19 PË. Mirëdita.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të vendoset në ekran  
21 dokumenti P00879.

22 PY. Dëshmitar, mund t'ju japim pak kohë që ta lexoni, por në  
23 këtë vendim ndalohet komunikimi me gazetarë për çështje  
24 ushtarake apo, për shembull, dhënia e intervistave apo e  
25 vlerësimeve. A është kjo në përputhje me politikën e UÇK-së

1 asokohe me ç'keni mbajtur ju mend?

2 PË. Unë së pari dokumentin po e shoh për herë të parë. Dhe po  
3 sa i përket si politika, normalisht, komunikimet u dasht ose  
4 janë të kufizuara ose të ditura kush mund t'i ketë  
5 komunikimet. Po.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që në ekran të vendoset  
7 U000-2988 në versionin në anglisht me ET përpara numrave.

8 PY. Dëshmitar, së pari, a e njihni firmën, nënshkrimin në  
9 këtë dokument?

10 PË. Po.

11 PY. A i njihni vendet të cilat shpjegohen në fillim të  
12 dokumentit, në krye të tij në rreshtin e parë?

13 PË. Po.

14 PY. A kanë qenë të gjitha këto zona të UÇK-së brenda zonës së  
15 Dukagjinit?

16 PË. Së pari dokumenti që kam këtu unë, shkon për zonën e  
17 Dukagjinit. Nuk shoh zona tjera.

18 PY. Por duke u bazuar tek njohuritë që keni ju për  
19 vendndodhjet e caktuara, a janë pjesë e zonës së Dukagjinit  
20 ato?

21 PË. Po.

22 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E shikojmë që këtu i referohet  
24 vendimit të Shtabit të Përgjithshëm të cilin sapo e pamë. Dhe  
25 dëshiroj që në ekran të shfaqet një dokument tjetër. Me numrin

1 SPOE00225272.

2 PY. Përpara se ta shohim këtë dokument, ju a kishit dijeni  
3 që, për shembull, kishte probleme ose çështje që kishin të  
4 bënë me zonën e Dukagjinit me persona që kanë folur me  
5 gazetarë?

6 PË. Po, ka pasur.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja e  
8 dytë, ju lutem, në versionin e gjuhës shqipe? Dëshiroj që të  
9 korrigjoj numrin, ju kërkoi ndjesë, është 225755.  
10 Faleminderit.

11 PY. Dëshmitar, a e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe në pikën e tretë mund të shikojmë që konfirmohet  
14 zbatimi i urdhrin të Shtabit të Përgjithshëm, është e saktë  
15 kjo?

16 PË. Po.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar, kërkoi të pranohet ky  
18 dokument, në fakt të dyja dokumentet. Pra, ky dokument që kemi  
19 në ekran, si edhe dokumenti i mëparshëm me numrin U000-2988  
20 ndërsa ky SPOE00225755.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
22 kundërshtime?

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kundërshtojmë sepse dokumenti  
24 i parë nuk është i plotë dhe nuk është i nënshkruar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

1 kundërshtimi juaj. Dokumenti U000-2988 dhe dokumenti  
2 SPOE0022575 pranohet.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një sqarim për  
4 dokumentin e parë. Kemi faqen e parë të këtij?

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, është faqja të cilën e pamë  
6 në ekran.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Okej. Dokumenti i parë  
8 me faqen e tij të parë me numrin U000-2988 dhe përkthimi në  
9 gjuhën angleze do të marri numrin e provës materiale P01390.  
10 Klasifikimi konfidencial.

11 Ndërsa dokumenti i dytë, SPOE00225755 dhe përkthimi në  
12 gjuhën angleze, do të marrin numrin e provës materiale P01391  
13 me të njëjtin klasifikim si konfidencial.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Mund të jenë të  
15 dyja publike. Mund të ketë qenë rasti që në fakt ka qenë faqja  
16 e dytë e dokumentit të parë por do ta shikojmë. Këtë do ta  
17 verifikojmë. Gjithsesi është faqja që pamë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dyja  
19 dokumentet të riklasifikohen si publike.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, e  
21 nderuar. Atëherë të dyja dokumentet riklasifikohen si publike.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]  
23 PY. T'i kthehemi tani rendit kronologjik dhe çfarë keni  
24 shpjeguar ju që ju është dashur që të ktheheshit nga Dukagjini  
25 për të ndihmuar me luftimet në Rahovec. Në atë kohë a keni

1 dëgjuar që ka patur një sulm në Opterushë?

2 PË. Jo.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që me lejen e  
4 Gjykatësit të tregojmë një deklaratë të mëparshme.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të sqarojmë nëse këtu kemi  
6 të bëjmë me 143(1) apo 134(2)? Pra, është rifreskim i memories  
7 apo ndonjë gjë tjetër?

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshmitar tha jo dhe kjo është  
9 një deklaratë e mëparshme.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të jemi të qartë, pra, nëse ka të  
11 bëjë me rregullën 134(2) që me anën e saj Prokuroria po vendos  
12 deklaratën tashmë, që të jemi të qartë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju lutem  
14 vijoni.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca është IT-05087\_1 T2489.  
16 Numri i faqes është 2508 në gjuhën angleze dhe faqja 22 në  
17 gjuhën shqipe.

18 PY. Në gjuhën angleze po lexoj nga rreshti 17. Pyetja ka qenë:

19 "A e dini që në korrik 1998 UÇK-ja sulmoi fshatin e  
20 Opterushës?"

21 Përgjigja:

22 "Kam dëgjuar se ka pasur një sulm në Opterushë, po nuk  
23 kam qenë atje. Unë kam qenë jashtë territorit të zonës së  
24 Pashtrikut. Unë isha në një zonë tjetër në rrethinat e  
25 Prizrenit. Atje e kam marrë vesh për të".

1 A ju rifreskohet kujtesa me këtë dëshmi?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, kjo pjesë që sapo ju lexova është e saktë?

4 PË. Po, e saktë është.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani dëshiroj që në ekran të  
6 shfaqet P00643 dhe do të qëndrojmë me faqen e parë të këtij  
7 dokumenti. Mund të shfaqet për të gjithë.

8 PY. A e shihni datën 23 korrik në atë faqe, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe poshtë saj shënohet që ju keni qenë aty dhe keni  
11 marrë e tyrë e kryeshefit të drejtorisë operative dhe më pas  
12 ka patur diskutime për rastin e Rahovecit. E mbani mend këtë  
13 takim?

14 PË. Detyrën e drejtorit të operativës e kam marrë ma herët.  
15 Ama diskutimi është diskutu për raste të Rahovecit sesi ka  
16 ndodhur, pse ka ardhë deri te ajo.

17 PY. Dhe diskutimi në këto shënime me ç'mund ta lexoni, a  
18 përkon me mënyrën sesi e keni kuptuar ju çfarë kishte ndodhur  
19 me rastin e Rahovecit?

20 PË. Po.

21 PY. Ku është mbajtur ky takim?

22 PË. Nuk më kujtohet. Kjo është koha veç kur ishim ne sulmet  
23 dhe ishte kohë ofensive. Nuk më kujtohet saktë ku ka qenë në  
24 cilin vend. Dikun sigurisht me këto si po shifet diku ka qenë  
25 në territorin e Malishevës, po ku nuk më kujtohet.

1 PY. A e mbani mend se kush ka qenë i pranishëm, kush ka marrë  
2 pjesë?

3 PË. Jo.

4 PY. Më parë ju keni thënë që i keni kërkuar Tahir Zemajt dhe  
5 dy vetëve të tjerë që të bëheshin pjesë e drejtorisë  
6 operative.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është në faqen 32 të asaj që keni  
8 thënë tek ZPS-ja.

9 PY. Dhe në fund të kësaj faqeje, është paragrafi i parafundit  
10 ku thuhet që u morr një vendim në lidhje me disa persona që  
11 duhet të raportonin në Shtabin e Përgjithshëm. T Zemaj,  
12 Rrustem Berisha, diçka që mund të jetë në N Maloku dhe dikush  
13 tjetër. A mund të na jepni një kontekst më të gjerë të kësaj  
14 çështjeje ose të mëtejshëm, ju lutem?

15 PË. Po. Është e vërtetë. Më kujtohet bash mirë se pasi jam  
16 kthyer nga vizita në Dukagjin, faktikisht edhe në Rahovec, në  
17 këtë takim, atëherë kam kërkuar se kam që e kam biseduar me  
18 disa eprorë të cilët kanë qenë në territorin e Dukagjinit se  
19 ishte Tahir Zemaj, Rrustemi, Naim Maloku e tjerë. Kam kërkuar që  
20 këta oficerë që transferohen për shkak të përvojave të tyre  
21 dhe profesionit që të vijnë në drejtorinë operative për të  
22 plotësuar drejtorinë operative dhe normalisht nga ana e  
23 shtabit është aprovuar që këta oficerë mund të vijnë. Mirëpo  
24 dhe pse është dërguar kjo që të kërkohen të vijnë, prej të  
25 gjithë këtyne vetëm Naim Maloku është thirrur kësaj përgjigjeje,

1 është përgjigje kësaj thirrjeje dhe ka ardhur në drejtorinë  
2 operative, të tjerët jo.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran  
4 dokumentin P00913.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më kanë thënë që një pjesë e  
6 përgjigjes së dëshmitarit, sidomos nga fundi nuk u përkthye.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj pjesën e fundit të përgjigjes  
9 suaj të paktën sipas procesverbalit dhe në rast se ka ndonjë  
10 gjë që dëshironi ta shtoni, ju lutem bëjeni këtë gjë. Atëherë  
11 ajo që kemi këtu të shkruar është që:

12 "... vetëm Naim Maloku iu përgjigj kësaj thirrjeje dhe  
13 erdhi në drejtorinë operative".

14 A thatë diçka tjetër përveç kësaj?

15 PË. Jo. Këta tjerët nuk janë përgjigjur kësaj thirrjeje dhe  
16 nuk kanë ardhë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt kështu e kuptova që tha  
18 edhe në përgjigjen e mëparshme dëshmitari.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

20 PY. Pra, ky vendim që kemi në ekran a përkon me atë që i keni  
21 shpjeguar ju, që sapo i keni shpjeguar Gjykatës?

22 PË. Po.

23 PY. Pra, ju na keni thënë që nga këta persona, vetëm Naim  
24 Maloku ju përgjigj thirrjes. A patët sukses për të marrë  
25 oficerë të tjerë përveç këtyre personave të shkruar këtu?



1 PË. Jo. Ne atëherë veç filluan luftimet e rrepta në të gjitha  
2 territoret e Kosovës dhe nuk kishim më mundësi që të mirremi  
3 me këtë çështje, po aq sa kemi mujt t'i ndihmojmë zonave të  
4 tjera për t'u mbrojtur.

5 PY. Po Kemal Shaqiri kur u caktua në zonën e Drenicës?

6 PË. Të njëjtën kohë kur edhe kanë vizituar në atë kohë zonën  
7 e Dukagjinit, Kemal Shaqiri është lajmëruar vetë që të vjen  
8 dhe ai është drejtu dhe është dërgu atëherë në zonën e  
9 Drenicës ku është vendos si shef shtabi i zonës së Drenicës.  
10 Përveç tina ka qenë edhe Shaban Draga të cilin njëjti ka  
11 ardhur nga ky grup dhe ka ardhun nalt në Brigadën 121,  
12 faktikisht në bjeshkën e Berishës si shef shtabi i brigadës.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani dëshiroj që t'i kthehem  
14 dokumentit P00643 dhe do të shkojmë në faqen e dytë të këtij  
15 dokumenti si në shqip ashtu edhe në anglisht. Dhe do të  
16 shikojmë pjesën e faqes nën nëntitullin mbledhja e 10 gusht.

17 PY. Pra, nën këtë nëntitull thuhet ka patur një diskutim për  
18 sa i përket komandantëve, formimin e brigadave dhe më pas  
19 jepet një listë me disa nga zonat dhe brigadat përkatëse. Keni  
20 qenë edhe pjesë e këtij diskutimi?

21 PË. Sa i përket këtij 16 gusht, domethënë, po. Në gusht duhet  
22 të jetë një diskutim që e kemi bërë në zonën e Drenicës.

23 PY. Kush tjetër ka qenë pjesë e këtij takimi?

24 PË. Nuk më kujtohen të gjithë kush kanë qenë, por sigurisht  
25 që kanë qenë edhe të drejtorisë operative. Se dhe kjo kohë ka

1 qenë në gusht dhe kanë qenë dhe ofensivat e ndryshme dhe nuk e  
2 di a kanë mujt me gjithnjë shtabi komplet, anëtarët e shtabit  
3 por gjithnjë ka qenë dikush nga shtabi. Dhe është diskutue  
4 gjatë raportit sesi është gjendja dhe deri ku ka arrit fillimi  
5 tash që dhe formimi -- transformimi i shtabeve lokale në  
6 brigadat. Unë tash nuk më kujtohet saktë kush kanë qenë krejt  
7 aty.

8 PY. Më parë ju keni shpjeguar një vizitë për në Llap gjatë  
9 ofensivave dhe dëshiroj t'ju tregoj dokumentin, 090568. E  
10 njihni vulën dhe nënshkrimin e këtij dokumenti?

11 PË. Po.

12 PY. A është e saktë që Kadri Kastrati ka qenë  
13 zëvendëskomandant i zonës së Llapit?

14 PË. Po, është e saktë.

15 PY. Dhe a ka qenë rreth kësaj kohe që ju keni bërë vizitën  
16 tuaj në zonën e Llapit?

17 PË. Po.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar, dëshirojmë, kërkojmë  
19 më saktë që ky dokument të pranohet.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
21 kundërshtim?

22 Megenëse nuk ka kundërshtime, atëherë dokumenti 090568  
23 pranohet nga Gjykata.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe mund të jetë publik.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe mund të

1 riklasifikohet si publik.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, 090568 dhe  
3 përkthimi në gjuhën angleze marrin numrin e provës materiale  
4 P01392 me riklasifikimin publik, dokument publik.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

6 PY. Më parë ju keni thënë që keni bërë dhe një vizitë të dytë  
7 në zonën e Dukagjinit rreth fundit të gushtit të 1998 së  
8 bashku me Hashim Thaçin, Rexhep Selimin dhe Lahi Brahimaj, për  
9 të diskutuar çështjen e atij se kush duhet të ishte komandant  
10 i zonës.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe është në intervistën tuaj me  
12 ZPS-në Pjesa 3, faqja 20.

13 PY. Dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje shtesë në lidhje me këtë  
14 çështje. Si ju informuan që kishte patur ndryshim në komandën  
15 e zonës së Dukagjinit?

16 PË. Po ne atë kohë na, gjatë kohës së gushtit, ishim në  
17 ofensivat sidomos në territorin e Drenicës dhe zonës së  
18 Pashtrikut. E di që në atë kohë më ka informuar Rexhep Selimi  
19 që ka ndodhur një ndryshim atje në zonën e Dukagjini, që na  
20 nuk kemi ditur, nuk kemi pas informacione për atë dhe  
21 normalisht jemi nisur së bashku me të. Jemi takuar në  
22 territorin e Malishevës me anëtarë të tjerë të shtabit dhe  
23 kemi vazhduar kemi shkuar në Dukagjin.

24 PY. Pasi ishit marrë me këtë çështje, a udhëtuan dhe anëtarë  
25 dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm me ju nga

1 Dukagjini apo shkuat me dikë tjetër?

2 PË. Në atë kohë ne kemi shku së bashku, Rexhep Selimi, Hashim  
3 Thaçi, Lahi Brahimi. Ne kemi qenë.

4 PY. Dhe në kthim udhëtuat së bashku?

5 PË. Nuk më kujtohet. Në kthim po bashkë jemi kthyer pi atiji.

6 PY. A kaluat Jabllanicën si rrugës për atje dhe në kthim?

7 PË. Po. Sidomos në kthim kemi kalu nëpër Jabllanicë, se kemi  
8 kaluar në këmbë, kemi kalu nga Jabllanica në këmbë dhe kemi  
9 kalu edhe lumin Drini i Bardhë dhe kemi dalë në territorin e  
10 Malishevës, faktikisht në Panorc dhe Mbrator.

11 PY. A ndaluar në Jabllanicë për të inspektuar njësitet ose  
12 për të bërë diçka tjetër atje?

13 PË. Në Jabllanicë jemi ndalur, aty kemi pushuar pak dhe kemi  
14 vazhduar natën se kemi prit të errësohet koha për të mujtur me  
15 lëvizë gjatë natës në atë pjesë të territorit të cilën e ceka  
16 pak më herët.

17 PY. Të ndryshojmë pak temë. A shkuat dhe në Sferkë  
18 për afërsisht në këtë periudhë kohore? Më falni, e dëgjuat  
19 pyetjen apo ta përsërisim?

20 PË. Jo. Përsëriteni ju lutem.

21 PY. Po. A shkuat edhe në Sferkë, Sverkë në këtë periudhë  
22 kohore që është fundi i gushtit, fillimi i shtatorit?

23 PË. Po mendoni në fshatin Sferkë? Po? Sferkë e Gashit? Kemi  
24 dhe ka kemi shku për në Dukagjin kemi kalu aty panaj, po edhe  
25 ka kemi kthy nga Dukagjini kemi kalu aty. Po.

1 PY. A morët pjesë në ndonjë takim atje në këtë periudhë  
2 kohore?

3 PË. Për qet periudhë kohore, jo.

4 PY. Po mesa ju kujtohet ju me përfaqësi kur keni marrë pjesë  
5 në një takim atje?

6 PË. Ma herët se ky rasti që ishim në Dukagjin. Kur ishte koha  
7 për unifikimin e njësive të fshatrave dhe ato njësi që ishin  
8 që ceka unë më herët që më pyetët për unifikimin e atyne  
9 fshatrave me një njësi, me një batalion i cili është formu si  
10 Batalioni i Dytë për zonën e -- për shtabin lokal të  
11 Rahovecit.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që të shfaqet në ekran  
13 materiali me numër P00075. Faqja 9300.

14 PY. Në të majtë, ka një pyetje: "Pyetje për Shtab të  
15 Përgjithshëm" dhe ka një listë pikash të ndryshme. Një prej  
16 pikave që renditet këtu -- pikë së pari, jo, Dëshmitar, a mund  
17 të më thoni kush ka marrë pjesë në këtë takim në Sferkë mesa  
18 ju kujtohet ju?

19 PË. Ky takim në këtë kohë kur jemi kthyer prej andej nuk u  
20 kanë në Sferkë po u kanë në Mbasor, në fshatin Mbrasor. I cili  
21 është afër dhe ai këtij territorit të Sferkës. Dhe ky grup i  
22 njëjtë i cili jemi tuj kthy nga Dukagjini.

23 PY. Pra, ju personalisht, Rexhep Selimi, Hashim Thaçi dhe  
24 Lahi Brahimaj, kështu?

25 PË. Më duket që ashtu. Q'ashtu ka qenë, se nuk më kujtohet

1 ndonjë takim tjetër veçantë kësaj kohe.

2 PY. Po atje me kë u takuat nga shtabi lokal?

3 PË. Më kujtohet me anëtarët e shtabeve lokale të Mbratorit.

4 Ka qenë edhe Binak Gashi ka qenë. Është diskutuar për

5 problematikat të cilat kanë qenë edhe këta të shtabit lokal të

6 Rahovecit se kishte do prapë probleme me disa njësite të cilat

7 ishin Ratkoc e në atë territor. Ça më kujtohet si mbas kësaj

8 shkrese këtu dhe këtij rastit.

9 PY. Pra, problematikat me njësinë në Ratkoc ishin pikërisht

10 këto që janë renditur tek kjo agjenda për rastin e Ratkocit të

11 Radostës, a është kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Apo nuk jeni i sigurtë?

14 PË. Po, po kishte probleme tash këto ishin problematikat të

15 cilat ishin në atë kohë.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga

17 ekrani. Faleminderit.

18 PY. Dimë që në shtator të 1998 ju jeni larguar nga Kosova për

19 të kryer disa detyra të tjera dhe jeni rikthyer sërish në

20 Kosovë në nëntor. Dhe keni thënë se keni marrë pjesë bashkë me

21 Kadri Veselin dhe me të tjerët në bisedimet me qeverinë në

22 mërgim gjatë kohës që ishit jashtë Kosovës.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo është pjesë e intervistës së

24 ZPS-së, Pjesa 14.

25 PY. Informuat ju anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm

1 në Kosovë lidhur me rezultatet apo me përfundimet e këtij  
2 takimi pasi u kthyet?

3 PË. Po, pasi jemi kthyer. Po dhe para se me u kthy kënejna  
4 kemi dhe anëtarë të shtabit kanë qenë edhe disa në Shqipëri si  
5 komandant i përgjithshëm e dinin, ata veç e kanë ditur dhe  
6 kanë qenë të informuar.

7 PY. Kadri Veseli u kthye në Kosovë me ju kur shkuat që të  
8 informonit personat që nuk kishin qenë në Shqipëri?

9 PË. Po, së bashku jemi kthyer nëntor.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që tani të shohim në  
11 ekran materialin me numër SPOE00229 deri në 217. Është  
12 versioni i Rishikuar, të paktën anglishtja është versioni i  
13 rishikuar. Dhe mund të transmetohet dhe për publikun.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, ky  
15 material ka numrin 4D00011.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj se ka  
18 një version dhe me më pak redaktime dhe e kemi dorëzuar, në  
19 fakt, është pranuar me numrin 4D00011-ET. Bëhet fjalë për  
20 versionin e Rishikuar dhe pasi të përfundoj me pyetjet e mia  
21 me dëshmitarin, do kërkoja që ky version i Rishikuar të  
22 zëvendësoj materialin ekzistues. Ka disa korrigjime shumë të  
23 vogla. Unë mund t'ua përmend.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për shembull, data është hequr

1 nga versioni i mëparshëm në anglisht, është përshtatur dhe  
2 formati në mënyrë që të afrohet sa më shumë me variantin në  
3 shqip.

4 PY. Në rregull. Dëshmitar, sipas këtyre shënimeve ose më  
5 saktë këto shënime janë pasqyrim i një takimi të 12 nëntorit  
6 1998. A keni marrë pjesë ju në këtë takim?

7 PË. Po.

8 PY. Cila ka qenë tema e këtij takimi?

9 PË. Tema e këtij takimit ka qenë dhe për marrëveshjen të  
10 cilën ne e kemi bërë në Shqipëri me Ministrinë e Mbrojtjes,  
11 faktikisht, me Qeverinë e Ekzistuese dhe me ristrukturimin e  
12 Shtabit të Përgjithshëm për nevojën të cilat veç u kërkojshin  
13 në atë kohë që të riorganizohet Shtabi i Përgjithshëm. Dhe  
14 kemi filluar ristrukturimin e këtij shtabi në këtë mbledhje.

15 PY. Ku është mbajtur ky takim?

16 PË. Këtë takim e kemi mbajtur të gjithë kemi qenë këtu  
17 prezent anëtarët e shtabit dhe që kemi diskutuar për  
18 transformimin e Shtabit të Përgjithshëm.

19 PY. Thoni "kemi qenë të gjithë të pranishëm", a mund të na  
20 jepni emrat e personave që kanë qenë të pranishëm?

21 PË. Sa më kujtohet, bash të gjithë nuk kanë qenë se  
22 komandanti s'ka qenë aty, nuk e di, ka qenë Rexhep Selimi,  
23 unë, Lahi Brahimi, Adem Grabovci, mundet dhe -- s'më kujtohen  
24 dhe tjerët. Të cilët kemi diskutuar kur kemi filluar në këtë për  
25 ristrukturim. Nuk më kujtohet a kanë qenë Jakupi dhe Hashimi.



1 PY. Po Kadri Veseli që ishte kthyer me ju a ishte i  
2 pranishëm?

3 PË. Kur kemi bisedu pastaj për ristrukturimin jo, në fillim  
4 po kur është raportue për qysh është zhvillue, qysh ka shkue  
5 ndodhën bisedimet. Mbasandej nuk e di, kur kemi fillu tani  
6 kemi bisedu ne për ristrukturim, po ai nuk ka qenë më duket  
7 aty. Sa më kujtohet tash. Është një kohë e gjatë.

8 PY. Ku janë mbajtur këto takime?

9 PË. Ky takim është mbajtur në bjeshkën e Berishës në Fshatin  
10 e Ri, Novosellë.

11 PY. Në këtë takim apo në takime të ngjashme të kësaj periudhe  
12 kohore jeni emëruar ju shef shtabi?

13 PË. Në këtë takim, kur kemi fillue, domethënë, gjatë  
14 ristrukturimit që atëherë.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, siç ju  
16 thashë më herët do të doja që versioni i Rishikuar në anglisht  
17 t'i bashkëngjitet versionit ekzistues ose të zëvendësojë  
18 versionin ekzistues.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
20 kundërshtime? Mesa duket jo.

21 Në rregull. Meqë nuk ka kundërshtime, ju lutem, materiali  
22 me numër SPOE00229217 *Revised* 1 zëvendëson materialin  
23 ekzistues dhe merr numrin 4D00011-ET.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë  
25 versioni I Rishikuar i provës materiale merr numrin 4D00011

1 dhe zëvendëson versionin ekzistues të anglishtes.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Publik është?

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në fakt është dokument  
4 publik.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kur morët detyrën e shefit të  
6 shtabit, a ju dhanë ndonjë organigramë ju të strukturës  
7 ekzistuese të Shtabit të Përgjithshëm?

8 PË. Jo. Në atë kohë nuk kanë pasur ndonjë strukturë  
9 ekzistuese të mëhershme. Po me këtë që po shifet në takim që  
10 kemi bisedu qetu kemi fillue të bëjmë strukturën që është bë  
11 struktura e re faktikisht.

12 PY. Atëherë si u informuat ju për strukturën e mëparshme?  
13 Thjesht përmes bisedimeve që pati në këtë takim?

14 PË. Jo, veç si mbas bisedimeve në këtë takim po dhe më herët  
15 kur jemi emru në pozitën e drejtorit të operativës e kam dit  
16 për disa drejtorë të cilat janë, cilat drejtorë janë dhe cilat  
17 janë funksionale që ishte në atë kohë drejtoria operative, ku  
18 isha dhe unë. Ishte drejtoria për marrëdhëniet me publikun dhe  
19 ndërkombëtare, ishte drejtoria për informim dhe ish-in -- u  
20 krijua drejtoria e financave, ça kam mujt me ditë në atë kohë,  
21 si drejtorë dhe që kanë funksionu. Ishte dhe zëdhënësi  
22 normalisht.

23 PY. Këto ua përshkruan apo ishte diçka që e vrojtuat vetë apo  
24 është diçka që e mësuat, pra, se cilat drejtorë ishin  
25 funksionale?

1 PË. Këtë e kam mësuar gjatë veprimit, domethënë, pasi jam  
2 emënuar si drejtor i drejtorisë operative gjatë kontakteve dhe  
3 veprimit.

4 PY. Ju përmendët informacionin edhe financën. A ka pasur  
5 drejtori të tjera para nëntorit?

6 PË. Nuk e di atë. Unë çka e di qeto i di që kanë qenun  
7 funksionale, cilat kanë qenë tjerat funksionale unë nuk e di.

8 PY. Pra, ka pasur një drejtor i operative sepse ju kishit qenë  
9 shefi i drejtorisë operative më përpara, apo jo?

10 PË. Po, kjartë.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të shihnim Shënimin Përgatitor  
12 numër 2, paragrafi 18, pra, numër 121825. Është vetëm në  
13 anglisht, nuk është nevoja ta vendosim në ekran. Thjesht doja  
14 të lexoja unë për ju.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj, sepse Shënimi  
16 Përgatitor 2 nuk është i pranuar si provë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E di, po unë thjesht dua ta  
18 përdor për t'i rifreskuar kujtesën dëshmitarit sepse ka një  
19 mospërrputshmëri me dëshminë që ju ka dhënë tani dhe diçkaje  
20 që ka thënë më herët.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni që nuk po heq dorë, po  
22 unë mendoj që në të tilla raste minimalisht të kërkohet leje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A po kërkoni  
24 leje që ta përdorni?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë po kërkoni leje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju jap leje.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Që të jetë e qartë kjo për  
3 procesverbal, ne duam të dimë a po përpiqet Prokurorja të  
4 diskretitoje dëshmitarin e vet lidhur me ndonjë aspekt  
5 konkret, prandaj u çova në këmbë dhe kërkova sqarim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

8 PY. Do t'ju lexoj paragrafin. Thotë --

9 Kjo është në një përgjigje të një pyetjeje që ju kam bërë  
10 për drejtorinë operative para nëntorit të 1998.

11 "Dëshmitar, rendit këto drejtori si drejtori ekzistuese  
12 para nëntorit të 1998: drejtorja e informimit, operativja,  
13 financa, zbulimi dhe logjistika në Shqipëri. Vetëm pas  
14 riorganizimit në nëntor të 1998 ... u shtua dhe drejtorja  
15 kadrovike apo drejtoritë e tjera".

16 Dëshmitar, a ju kujtohet që e thatë këtë javën e kaluar?

17 PË. Plotësisht. Edhe tash e thashë të njëjtë cilat drejtori  
18 janë, të cilat i kam thënë para se të organizohet.

19 PY. Pjesa që unë sapo ju lexova a është e saktë?

20 PË. Po, po, e saktë është. Dhe veta i përmenda dhe unë.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran  
22 materialin me numër P010016.

23 PY. Dëshmitar, e njihni vulën dhe nënshkrimin në këtë  
24 dokument?

25 PË. Po.

1 PY. I kujt është ky nënshkrim?

2 PË. Nënshkrimi është i Jakup Krasniqit.

3 PY. Këtu flitet për një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm  
4 të mbajtur më 12 nëntor 1998. A ka qenë kjo një nga temat që  
5 është diskutuar po ashtu në atë mbledhje?

6 PË. Po. Siç e ceka dhe në takim, domethënë, është mbajtur  
7 riorganizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të shtabit,  
8 po edhe zonave më poshtë dhe në atë takim është mbajtur që  
9 nënzonat që shndërrohen në zona operative.

10 PY. A ju kujtohet të jetë bërë ndonjëherë ndonjë diskutim  
11 brenda UÇK-së për reduktimin e zonave operative nga shtatë në  
12 tre zona?

13 PË. Mua s'më kujtohet ajo.

14 PY. Do flasim pra, për zonat operative po do flasim për një  
15 periudhë tjetër kohore.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për këtë do të doja që në ekran  
17 të shfaqej materiali P01108.

18 Dhe tek shqipja pak më poshtë ju lutem që të shohim  
19 pjesën ku duken nënshkrimet.

20 PY. A ju kujtohet ky komision për caktimin e kufijve të  
21 zonave operative?

22 PË. Po.

23 PY. Personat që përmenden këtu - Rexhep Selimi, Fatmir Limaj  
24 dhe Sali Veseli - as kanë qenë personat e caktuar për të  
25 punuar me këtë çështje?

1 PË. Po.

2 PY. Kufiri u vendos nga qendra apo dhe u bë dhe në koordinim  
3 apo bashkërendim me komandantët e zonave?

4 PË. Po të gjitha kufijtë janë bashkërenditur së bashku edhe  
5 jo vetëm nga qendra po dhe nga dhe me komandantët e zonave,  
6 mvarësisht prej asaj sesi ka qenë situata dhe si është qenë  
7 gjendja në terren.

8 PY. Pra, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm shkuan vetë në  
9 terren për ta kryer këtë detyrë?

10 PË. Jo. Grupi që ka shkuar atje është se më herët kanë qenë  
11 të përcaktuar dhe të biseduar këto kufij. Ato janë vendosur  
12 njëherë në pjesën në letër. Dhe komisioni pastaj, ky grup ka  
13 shkue që të vërteton, të shef këtë vijë ndarëse të dy zonave  
14 dhe aty ku ka probleme, është problem varësisht prej asaj sesi  
15 situata sesi është në terren, që mund të përmirësojnë ose të  
16 lëvizim këtë vijë të kufirit të përgjegjësisë së zonave.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do të doja të shfaqej në  
18 ekran materiali SPOE00226624. Do të shohim faqen 2, ju lutem.

19 PY. Në fund të faqes mund të shohim që përmendet komisioni i  
20 caktimit të vijave kufizuese, për të cilat sapo diskutuam.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] T'i kthehemi faqes 1.

22 PY. Në fund të faqes përmendet edhe komisioni i promovimeve  
23 që duket sikur është -- komisioni i gradimit - më falni. A ju  
24 kujtohet që të ketë pasur një komision të tillë?

25 PË. Po. Është fol për një komision të tillë gradimi, mirëpo

1 për atë kohë nuk ka mund të ketë komision të tillë se për  
2 gradime u dasht një proces krejt tjetër për mund të gradohen  
3 oficerët në këtë kohë.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
5 pranohet ky dokument.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Kundërshtoj. Nuk e di nga e ka  
7 prejardhjen, kush pretendohet se e ka shkruar. Dëshmitari  
8 thjesht tha që ka pasur disa diskutime, nuk u thellua më tej.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mjafton kaq.  
10 Doni të kundërpërgjigjeni?

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Besoj se dëshmitari ka përshkruar  
12 një sërë çështjesh që gjenden në këtë dokument dhe ai  
13 përshkruan si fakt sepse janë diskutuar në atë kohë. Ai ka  
14 shpjeguar dhe për komisionin e gradimit që është i fshirë këtu  
15 është me kryq dhe tha që nuk u realizua ky komision. Ka  
16 përshkruar komisionin për zonat operative. Besoj që baza është  
17 e mjaftueshme për të pranuar dokumentin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
19 Dokumenti është relevant, autentik dhe ka vlerë provuese dhe  
20 përmbush kriterin *prima facie* që nevojitet sipas rregullës  
21 138. Rrjedhimisht dokumenti pranohet.

22 Dokumenti SPOE00226624, vetmen faqja 2 apo keni ndonjë  
23 faqe tjetër që doni të pranohet?

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe faqja 1 edhe faqja 2.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund ta shohim faqen 1? Se vetëm

1 2 kemi në ekran?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po besoj se e  
3 pamë edhe faqen numër 1?

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në rregull. Sidoqoftë një nga këto  
5 faqe nuk e kemi parë.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në fakt të dyja faqet i pamë.  
7 Filluam me faqen 2 dhe pastaj kaluam tek faqja 1.

8 Këtu flitet për komisionin e përkohshëm të caktimit të  
9 vijave kufizuese pamë fillimisht këtë faqe, pastaj shkuam tek  
10 faqja tjetër.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12 Faleminderit.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 materiali me numër SPOE00226624 deri në SPOE00226625 bashkë me  
15 përkthimin në gjuhën angleze merr numrin e provës materiale  
16 P01393 dhe klasifikohet si konfidencial.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si  
18 dokument publik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
20 Riklasifikojeni ju lutem.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nëse është e volitshme për ju,  
22 mund të bëjmë pushimin.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
24 bëjmë dhjetë minuta pushim. Dhe do të rikthehemi pretë  
25 përfunduar me ditën e sotme dhe se kemi dhe një orë të fundit.



1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë  
3 minuta pushim.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 15.31

5 --- Seanca rifillon në orën 15.41

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
7 sillni në sallë dëshmitarin.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni i  
10 gatshëm të vijojmë z. Zyrapi?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
13 në rregull. Faleminderit.

14 Atëherë mund të vazhdoni Prokurore, znj. Lawson.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë nëse mund  
16 të vendosim në ekran P00647, ju lutem.

17 PY. A mund të na shpjegoni se çfarë është kjo ju lutem?

18 PË. Kjo është regjistër i dokumentave të protokollit, të  
19 protokolluara në Shtabin e Përgjithshëm.

20 PY. A e njihnit një këtë lloj regjistri, apo e dinit që ky  
21 lloj regjistri mbahej?

22 PË. Po, e di që është mbajtur si protokollet edhe ka pas edhe  
23 në shtab, domethënë komandanti shtabit, kam pas edhe unë si  
24 shef shtabit protokollin edhe është e njoftur.

25 PY. A ka patur regjistra të tjera të dokumenteve të

1 protokolluara përveç asaj që mbanit ju si shef shtabi?

2 PË. Besoj se ka pas edhe drejtoritë. Kjo është i Shtabit të  
3 Përgjithshëm, i komandantit të shtabit.

4 PY. Dhe ku mbahej ky regjistër?

5 PË. Ky ka qenë te komandanti tash. Sa kohë [E pakuptueshme]  
6 nuk e di. E di që te komandanti ka qenë.

7 PY. E keni fjalën mbahej në Shqipëri, apo me  
8 zëvendëskomandantin në Kosovë?

9 PË. Jo, jo me zëvendëskomandantin në Kosovë, se në Shqipëri  
10 nuk është mbajtur.

11 PY. Më parë --

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga  
13 ekrani.

14 PY. Më parë ju keni folur për rregullat provizore për  
15 organizimin e jetës së brendshme të UÇK-së. Dhe në fakt ju i  
16 keni dhënë edhe TPNJ-së një kopje të këtij dokumenti. E  
17 kuptoni për çfarë dokumenti e kam fjalën?

18 PË. Të Rregullores, po. Rregullores, apo rregullave?

19 PY. Rregullat e brendshme për organizimin e jetës së  
20 brendshme të ushtrisë, që në vetvete është një rregullore.

21 PË. Po.

22 PY. Kur e kishit parë për herë të parë këtë kopje ose kishit  
23 marrë për herë të parë kopje të këtyre rregullave?

24 PË. Si rregull i kam pa këto nëntori, dhjetori, se më herët  
25 nuk kam pas mundësi ta shof. Ajo edhe pse thotë më herët ka

1 qenun diku është një rregullore, por unë në q'atë kohë e kam  
2 pas, pse pastaj është dhënë që të punohet, të përpunohet edhe  
3 më mirë ajo Rregullore dhe është punuar në atë drejtim. Me  
4 parë q'atëherë e kam pa, nuk e kam pa ma herët.

5 PY. Po ju e dinit që kishte ekzistuar edhe më parë?

6 PË. Po.

7 PY. E tani të kalojmë tek një dokument tjetër. Është  
8 Rregullorja.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me numër P00083. Ndërsa versioni  
10 në anglisht ka edhe ET në fund. Nëse mund të kalojmë tek faqja  
11 e dytë në mënyrë që dëshmitari të mund të shikojë dokumentin  
12 në fjalë. Si dhe në faqen tjetër.

13 PY. A e njihni, e kuptoni se çfarë është kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, po. Kjo është dokumenti i Rregullores së Brendshme të  
15 UÇK-së, të Shtabit të Përgjithshëm.

16 PY. A mbani mend që këto rregullore të Shtabit të  
17 Përgjithshëm të ekzistonin?

18 PË. Po. Kjo faktikisht është [E pakuptueshme] dhe kjo është  
19 përpunu dhe është plotësuar qysh në nëntor, dhjetor masandaj,  
20 në këtë periudhë të ristrukturimin. Dhe është dhënuar e ka pas  
21 Shtabi i Përgjithshëm edhe më poshtë edhe zonat.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në faqen e  
23 fundit të këtij dokumenti. Dhe në fund të tij të kësaj faqeje.

24 PY. Këtu mund të shihni që është e papërfunduar. A ka patur  
25 faqe të tjera ky dokument? Faqe të cilat nuk janë të shfaqura

1 këtu që shpjegonin ndoshta të gjitha drejtoritë secilën prej  
2 tyre një më një?

3 PË. Po. Të gjitha drejtoritë janë shpjeguar. Se në këtë  
4 rregull brenda janë spjegu prej përgjegjësisë të Shtabit të  
5 Përgjithshëm, drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm [E  
6 pakuptueshme] cilat janë përgjegjësitë dhe kanë qenë të  
7 shpjeguara këto. Të shkruara këto. Kanë qenë edhe detyrat e  
8 drejtorive, drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani dëshiroj të kalojmë në  
10 disa rregullore të tjera, P00508.

11 PY. A e mbani mend që ka pasur dhe rregullore të disiplinës?

12 PË. Po.

13 PY. A e mbani mend se kur janë përpiluar apo përgatitur ato?

14 PË. Nuk e di më herët, di që kam pasur, por edhe në këtë kohë  
15 kur kemi fillu rreth ristrukturimit kemi fillu edhe këto  
16 rregullore të përshtatë, në faktikisht, të përkthehen që të jenë  
17 funksionale për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Po nuk kemi  
18 arritur gjithsej pse s'ka qenë detyra ime, ka qenë detyrë e  
19 sektorit tjetër, sektorit juridik që ta punojë mirë në mënyrën  
20 për shkak se bënte -- rregullore disiplinore e cila kërkon që  
21 të jesh jurist të punon në këtë drejtim.

22 PY. A ka patur ndonjë version të këtyre rregullore që kanë  
23 ekzistuar përpara muajit nëntor 1998?

24 PË. Nuk e di, e di që po, ka pasur, por unë nuk e kam parë  
25 atë.

- 1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani dëshiroj që në ekran të  
2 vendoset SPOE00223619.
- 3 PY. A mund të na shpjegoni se çfarë është kjo që shihni në  
4 ekran?
- 5 PË. Po, është edhe kjo një përshkrim detyrash të G1-shit ose  
6 S1-shit, G1-shi është një paraqet sektorin e personelit. Kjo  
7 nuk është e Shtabit të Përgjithshëm, kjo është e zonave  
8 operative, më poshtë, domethënë, zonave dhe brigadave. Ku  
9 shpjegon detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë këto, ky sektor  
10 në këto nivele.
- 11 PY. A ka patur përshkrime të tilla pune për oficerët në nivel  
12 zone dhe në këto lloj nivelesh?
- 13 PË. Po. Kur folim [E pakuptueshme] këto krejt ma vonë janë bo  
14 edhe në kohën, domethënë, dhjetorit, janarit, dhjetor 1998,  
15 janar 1999.
- 16 PY. Kush i ka përpiluar ato?
- 17 PË. Varësisht, për shtabin janë përpiluar në shtab, kurse të  
18 zonave kemi fillu prej zonave, si grupi i parë i cili ka ardh  
19 ka hy brenda kur kemi bërë marrëveshjen, ato veç i kemi pas  
20 përkthyer këto detyra dhe rregullat edhe përgjegjësitë, veç i  
21 kam marrë nga ta dhe i kemi dërguar, lëshuar zonave të tjera,  
22 dhe njërive të tjera, të cilat i kanë marrë dhe i kanë shti në  
23 funksion nëpër zonat e veta.
- 24 PY. Pra, kur i referuat grupit të parë, a mund të na  
25 shpjegoni shprehimisht se kush janë ata? Cilët grupe i

1 referoheshit?

2 PË. Grupit të oficerëve të cilët pas marrëveshjes që kemi  
3 bërë me Ministrinë e Mbrojtjes në Ekzil, është grupi i parë i  
4 oficerëve që ka hyrë në nëntor, prej tyre është marrë kjo --  
5 këto -- ky dokument.

6 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Kërkoj të pranohet  
8 ky dokument.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
10 kundërshtime?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne do të shprehemi në  
13 kundërshtim për mënyrën se si është sekuestruar ky dokument  
14 nga shtëpia e z. Jakup Krasniqi, pra u qëndrojmë atyre  
15 kundërshtimeve.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
17 pranohet dokumenti me numër SPOE00223619.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nëse mund të kërkojmë  
19 sqarim nëse është vetëm një faqe e këtij dokumenti apo  
20 dokumenti i plotë?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I gjithë dokumenti, një dokument  
22 i tërë. Dhe mund të kenë klasifikimin si dokument publik.

23 SEKTARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, dokumenti me  
24 ERN-në SPOE00223619 deri në 00223621 dhe përkthimi në gjuhën  
25 angleze merr numrin e provës materiale P01394. Me klasifikimin

1 e tanishëm si dokument si dokument konfidencial.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 SEKTARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Riklasifiokhet si  
4 dokument publik. Faleminderit.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

6 PY. Që nga nëntori i vitit 1998 e deri në 1999, ku ka qenë me  
7 bazë Shtabi i Përgjithshëm?

8 PË. Nga nëntori i 1998 deri në mars 1999 Shtabi kryesisht,  
9 pjesën më të madhe ka qenë në fshatin Divjakë, në malet e  
10 Berishës.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pra, prapë për këtë periudhë,  
12 mars në nëntor, dëshiroj që në ekran të vendoset dokumenti  
13 SPOE00082284. Dhe fillojmë në faqen 2 të këtij dokumenti, si  
14 të versionit në shqip edhe të atij në anglisht.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në gjuhën shqipe  
16 materiali ka vetëm një faqe.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë do të na duhet t'i  
18 kthehemi këtij dokumenti më vonë, pasi ta kemi verifikuar atë.  
19 Pra, kur të kemi versionin e plotë të tij. Atëherë le të  
20 vijojmë me dokumentin SPOE00229683.

21 Ndjesë, ju kërkoj ndjesë sepse ndërrova mendjen sërish,  
22 por po e kalojmë të gjithë këtë pjesë derisa t'i kemi të  
23 gjitha dokumentat e duhura. Më lejoni të kalojmë te P00688 si  
24 dokument. Faleminderit. Do të fillojmë me faqen e fundit për  
25 të parë si fillim nënshkrimin.

1 PY. A e njihni vulën dhe nënshkrimin në këtë dokument,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Çfarë vule është ajo dhe i kujt është nënshkrimi?

5 PË. Vula është e Shtabit të Përgjithshëm, nënshkrimi është i

6 Jakup Krasniqit.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë mund të kalojmë tani tek

8 faqja e parë e këtij dokumenti.

9 PY. Në dokument shpjegohen marrëdhëniet me vëzhguesit e OSBE-

10 së, dhe ka edhe një listë individësh për zonat e ndryshme. Me

11 çfarë dini ju, bashkërendimi i punës me KDOM-it, me vëzhguesit

12 e KDOM-it, ka qenë pjesë e detyrave të personave që përmenden

13 në këtë listë?

14 PË. Po.

15 PY. Faleminderit.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të vazhdojmë tani me

17 dokumentin SPOE00225147.

18 PY. Atëherë duke parë pjesën e fundit të këtij dokumenti e

19 dini për cilin spital bëhet fjalë këtu?

20 PË. Sipas kësaj që po e shoh këtu, është spitali i Drenicë.

21 PY. Dhe ku ishte ky spital?

22 PË. Nuk e di. Sa më kujtohet diku ka qenë afër Likovcit diku.

23 PY. Dhe autori i dokumentit është Fadil Beka. Kush ka qenë

24 Fadil Beka?

25 PË. Fadil Beka ka qenë që e ka udhëheq spitalin, po ka qenë



1 edhe kryesor për shërbimin medical në Ushtrinë Çlirimtare të  
2 Kosovës.

3 PY. Kush e ka emëruar në atë detyrë?

4 PË. Ai ka qenë veç në këtë detyrë moti kur kam ardhë unë. Veç  
5 në atë kohë veç ka qenë në këtë detyrë.

6 PY. Mund të shikojmë këtu që ka kërkesë, pra, bëhet një  
7 kërkesë për mbështetje. Shtabi i Përgjithshëm e ka dhënë këtë  
8 lloj mbështetje logjistike për spitalet e UÇK-së?

9 PË. Shtabi aq sa ka pas mundësi, vetë ai gjithnjë ka dhënë  
10 ato mbështetjet edhe spitaleve, jo veç në Drenicës, por dhe të  
11 tjerave.

12 PY. Ka patur edhe kuadro mjekësore në brigada përveçse në  
13 spitale?

14 PË. Po. Gati në çdo brigadë ka pasur mjekë të cilët ka qenë  
15 ose ndryshe i kemi quajt ambulanta.

16 PY. Për Brigadën 121 kush ka qenë personi që mbulonte fushën  
17 mjekësore atje?

18 PË. Në Brigadën 121 në atë kohë e ka mbulue Fitim Selimi,  
19 mjeku.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj të pranohet ky dokument,  
21 ju lutem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ka  
23 kundërshtime?

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I njëjti kundërshtim që ne i  
25 qëndrojmë pjesës që ka të bëjë me kontrollin dhe marrjen e

1 këtij dokumenti.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Dokumenti SPOE00225147 pranohet dhe do të ketë  
4 klasifikimin publik.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, mund të ketë klasifikim të  
6 tillë. Faleminderit.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, dokumentit  
8 i jepet numri i provës materiale P01395, dhe do të  
9 riklasifikohet si dokument publik.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani në ekran të vendosim  
13 dokumentin SPOE00225789. Do t'ju lutesha të kalojmë në fund të  
14 dokumentit. Ju lutem, të kalojmë tek faqja e dytë e këtij  
15 dokumenti. Ju kërkohet ndjesë.

16 PY. A e njihni nënshkrimin në fund të këtij dokumenti?

17 PË. Po.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani do t'ju lutesha të  
19 kalonim sërish tek faqja e parë e këtij dokumenti.

20 PY. Këtu mund të shikojmë që ka, janë të listuara një sërë  
21 dokumentesh nga Shtabi i Përgjithshëm. E para ka të bëjë me  
22 atë që sapo e pamë pak më përpara dhe që ka bëjë me vëzhguesit  
23 e KDOM-it të OSBE-së. E treta, e pamë edhe këtë përpara pak  
24 kohe, dhe ka të bëjë me shndërrimin e nënzonave në zona. E  
25 katërta ka të bëjë me emërimin e Sokol Dobrunës, dhe a është e

1 saktë që ai u emërua në sektorin juridik në kabinetin e

2 komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

3 PË. Po.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër, ju

5 lutem.

6 PY. Të shohim që ka disa kërkesa që janë shtruar. Një syresh

7 ka të bëjë me rolin e shefit të shtabit në zonën e Dukagjinit.

8 A ka -- a kam të drejtë kur them që ky post ka qenë i lirë

9 asokohe? Nuk ka pasur një person të caktuar?

10 PË. Po.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të

12 pranohet ky dokument.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ka

14 kundërshtime?

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, i njëjti kundërshtim,

16 lidhur me mënyrën se si janë marrë këto materiale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me

18 numër SPOE00225789 pranohet.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë publik.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

21 Riklasifikojeni si material publik.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 materiali merr numrin 01396 dhe do të riklasifikohet si

24 publik.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të shfaqet tani në ekran

1 materiali me numër SPOE00225794.

2 PY. Si fillim, a e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet ta keni marrë këtë kërkesë lidhur me  
5 grushtin afër kokës? Është miratuar?

6 PË. Jo. Përshëndetja ka jetë me dorë të shtrirë.

7 PY. A e njihni shkrimin e dorës në këtë dokument?

8 PË. Po, është edhe shkrimi jem.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet ky  
10 dokument.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
12 kundërshtime?

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I njëjti kundërshtim si më  
14 përpara.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
16 [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Materiali me numër SPOE00225794  
17 pranohet dhe riklasifikohet si publik.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e  
19 provës P01397 dhe do të riklasifikohet si publik bashkë me  
20 përkthimin në gjuhën angleze.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do të doja të vendosej në  
23 ekran materiali me numër P00638.

24 PY. A e njihni këtë dokument dhe a është kjo përgjigjen për  
25 kërkesën që sapo pamë një çast përpara?

1 PË. Po, kjo është. Dokumenti është i imi, nënshkrimi është  
2 imi, dhe vula është e shtabit.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani shohim dokumentin që mban  
4 numrin P00614.

5 PY. Ky dokument ka të bëjë me emërimet e Brigadës 123. A ju  
6 kujtohet kur janë bërë këto emërime?

7 PË. Së parit nuk më kujtohet fare se ky dokument nuk është as  
8 i nënshkrum nga unë, po të ishte i nënshkrum atëherë do të  
9 kisha thënë që është dokumenti im dhe këta persona në këto  
10 detyra nuk përcaktohen nga Shtabi i Përgjithshëm, por  
11 përcaktohen nga zonat operative -- nga komandantët e zonave.

12 PY. Data është dhjetor 1998. A ka ndonjë arsy -- a ka ndonjë  
13 arsye pse në këtë rast është marrë drejtoria operative me këtë  
14 çështje dhe kjo komanda e zonës?

15 PË. Mund me kon për shkak që komandanti i zonës ende s'a kon  
16 aty i vendosur edhe shtabi hala a kone në formim.

17 PY. A ju kujtohet të jenë emëruar këta persona te Brigada  
18 123?

19 PË. Po. Këta persona janë të emëruar në këto detyra, në këto  
20 brigadën -- në këtë brigadë. Nuk janë emëruar prej meje, por  
21 prej komandantit të zonës.

22 PY. A ju kujtohet me përafërsi kur janë kryer këto emërime?

23 PË. Jo.

24 PY. A mund të ketë ndodhur pas kësaj date, sepse ju thatë që  
25 në këtë moment komandanti i zonës nuk ka qenë në Kosovë?

1 PË. Me këtë datë ende s'ka qenë komandanti i zonës aty edhe  
2 ishte shtabi në zhvillim në atë kohë, ristrukturimi i Shtabit  
3 të Përgjithshëm. Tash po të ishte kështu, pse nuk është  
4 nënshkrimi im edhe vula? Po të ishte unë të emënuar nga shtabi  
5 edhe nga unë personalisht, siç shkruhet me emën këtu, edhe të  
6 ishte i nënshkruar edhe u vulosur. Në atë kohë kam pas edhe  
7 vulën, nënshkrimin, protokollin.

8 PY. Nëse e kuptoj unë siç duhet, ju po thoni që këta persona  
9 nuk janë emëruar me këtë vendim. Por në fakt janë emëruar në  
10 këto poste dhe se janë emëruar në këto poste nga komandanti i  
11 zonës. A e kam kuptuar drejtë?

12 PË. Pikërisht ashtu.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do të doja që të shihnim në  
14 ekran materialin SPOE00225132.

15 PY. Vulën dhe nënshkrimin këtu e njihni?

16 PË. Po. Është vula e shtabit, nënshkrimi është i Jakup  
17 Krasniqit.

18 PY. A mund të na jepni kontekstin për çfarë është ky dokument  
19 dhe pse i është drejtuar Brigadës 121?

20 PË. I është drejtuar Brigadës 121 se në atë kohë ishim në  
21 zhvillim dhe nuk kishim njësi pranështabore të cilët mund t'i  
22 ndihmonin z. Jakup Krasniqi t'i transferon ose t'i bartë  
23 tavolinat dhe karriget dhe të gjitha pajisjet që janë kon të  
24 nevojshme për zyrën ku ai është bart në shtëpinë në Divjakë.

25 PY. Divjaka ishte pjesë e zonës së përgjegjësisë së Brigadës

1 121?

2 PË. Po. Tërësisht jo veç fshatit Divjakë, po edhe Bjeshka e  
3 Berishës ka qenë zona e përgjegjësisë së Brigadës 121.

4 PY. Nga pikëpamja gjeografike, a mund të na e shpjegoni  
5 shtrirjen e zonës së përgjegjësisë të Brigadës 121?

6 PË. Siç e ceka domethënë, Bjeshka e Berishës në tërësi, duke  
7 marrë prej Grykës së Llapushnikut, fshatrat pastaj te [E  
8 pakuptueshme] nga pjesës -- një pjesë të fshatrave të  
9 Lipjanit, janë të përfshime te Kishnarekë, Baicë, në dalje në  
10 Shalë, pastaj Blinajë, Bjeshka, deri në Pjetërshticë dhe del  
11 deri në -- në pjesën e Carralevës. Dhe gjatë rrugës Prishtinë,  
12 faktikisht është Shtimje-Suharekë, rrugës deri në qafë të  
13 Duhlës. Dhe prej asaj është shtrirë poshtë në pjesën e fshatit  
14 Bllacë, Temeqinë, pastaj prej atyhit ka shku në pjesën e  
15 drejtimit të Banjës dhe është ngrit nalt prej drejtimit  
16 fshatit Lladrovç edhe ka dalë prapë te drejtimi -- në drejtim  
17 të Grykës së Llapushnikut.

18 Ka disa fshatra të tjera, por nuk po më kujtohen për  
19 momentin.

20 PY. A keni pasur ndonjë përfshirje në përcaktimin e kufijve  
21 të zonës së -- të Brigadës, më falni, 121?

22 PË. Po. Normalisht kemi punuar atje në [E pakuptueshme] në  
23 brigadën, përfshirë edhe zonës së saj, edhe unë edhe Rexhep  
24 Selimi, edhe komandanti i brigadës.

25 PY. Në kohën që keni punuar ju me këtë brigadë, kush ka qenë

1 komandant?

2 PË. Në atë kohë ka qenë komandant Fatmir Limaj.

3 PY. Folëm për kufijtë e zonave më herët, për zonën e  
4 përgjegjësisë së brigadave. Çfarë procesi ndiqej për  
5 përcaktimin e kufijve? A i vendoste qendra kufijtë apo kjo  
6 kryhej në bashkëpunim me komandantët e zonave? Ju lutem na e  
7 shpjegoni këtë.

8 PË. Unë këtë e shpjegova edhe herët, kur ma bone pyetjen, sa  
9 i përket zonave operative nga qendra është përcaktu. Pastaj  
10 për brendësinë të zonave të brigadat, në bashkëpunim me  
11 komandantat e zonave dhe brigadave të asaj zone, është bërë  
12 edhe përcaktimi i zonës të përgjegjësive të këtyre njësive.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Përpara se të vijojmë me temën  
14 tjetër do të doja që të pranohej ky dokument.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
16 kundërshtime? Me sa shoh nuk ka kundërshtime.

17 Dokumenti SPOE00225132 pranohet.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
19 numrin e provës P01398. Dhe klasifikimin e ka konfidencial.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë edhe një dokument  
21 publik.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
23 Riklasifikojeni si publik.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran  
25 materialin SPOE00225263.



1 PY. E njihni vulën dhe nënshkrimin në këtë dokument?

2 PË. Po. Vula e Shtabit të Përgjithshëm, nënshkrimi i Jakup  
3 Krasniqit.

4 PY. Këtu flitet për drejtorinë e financave. A ishte Jakup  
5 Krasniqi kompetent për të lëshuar urdhra të tillë?

6 PË. Po si zëvendëskomandant, po.

7 PY. Ushtari që përmendet këtu, Sami Vehapi, a është me sa  
8 keni ju dijeni, Sami Vehapi ka pasur ndonjë rol koordinues për  
9 financat?

10 PË. Gjatë kohës ka dhënë një lloj koordinimi për financat, të  
11 cilat ka pas koordinim mes Brigadës 123 dhe kanë pas në atë  
12 kohë kanë qenë edhe këshillat e financave që kanë qenë nëpër  
13 nivele të komunave dhe në nivelet lokale që të ketë një  
14 bashkëpunim mes këshillit të financave dhe UÇK-së për furnizim  
15 ose për financim të këtyre njësive.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
17 pranohet ky dokument. Ky dokumenti mund të jetë publik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
19 kundërshtime?

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po dëshmitari nuk ka thënë që  
21 e ka parë këtë dokument. I thanë lexoje dokumentin, dhe i  
22 thanë a e njeh nënshkrimin.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë  
24 kundërshtimi keni?

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dëshmitari nuk ka dijeni a ka

1 qarkulluar një dokument i tillë asokohe, thjesht lexoi  
2 dokumentin.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me  
4 numër SPOE00225263 pranohet.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin  
6 P01 -- 1, më falni, 1399. Është konfidencial.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
8 Riklasifikojeni si publik.

9 Znj. Lawson, mendoj që do ta mbyllni me ditën e sotme.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
12 për sot përfunduar. Faleminderit që erdhët. E dimë që dita  
13 është e gjatë. Tani mund të largoheni me Asistenten e sallës.  
14 Do të shihemi nesër në orën 9.00. Nesër do të përfundoni në  
15 orën 1.00 të drekës dhe do të largoheni në orën 1.00. Dhe do  
16 ta riorganizojmë pjesën e mbetur të javës.

17 Edhe një herë faleminderit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të pyes Prokuroren si e ka  
20 planifikuar për ditën e nesërme. Do ta përfundojë gjithë ditën  
21 Prokurorja nesër apo jo?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, besoj se do të përfundoj  
23 pothuajse gjithë kohën e ditës së nesërme.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
25 Faleminderit. Shihemi nesër në orën 9.00.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25